Iniciativa e Transparencës së Industrisë Nxjerrëse

STANDARDI EITI 2019

Standardi global për qeverisjen e mirë të naftës, gazit dhe burimeve minerale

17 Qershor 2019

Përfundimi i publikimit të standardit EITI, përmban kapitulli i parë – Zbatimi i Standardit EITI dhe kapitulli i dytë – Qeverisja dhe menaxhimi.

Standardi i shkurtuar i EITI, përfshihet në kapitullin e parë – Zbatimi i Standardit EITI

Faqja e internetit të EITI që përmban Standardin e plotë të EITI, shënime udhëzuese dhe shembuj.

eiti.org/guide

Standardi EITI 2019
Botimi 1, 17 qershor 2019
Ky botim i Standardit EITI është publikuar për Konferencën Globale 2019. Një botim i dytë do të publikohet më vonë në 2019 së bashku me Aktin e Themelimit, të miratuara në Takimin e Anëtarëve të datës 17 qershorit.

Sekretariati Ndërkombëtar i EITI

Ky botim (me përjashtim të logos) mund të riprodhohet falas në çdo format ose mjet, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe të mos përdoret në një kontekst mashtrues.

Materiali duhet të njihet me të drejtat e autorit të EITI, ku të jetë specifikuar titulli dhe burimi i botimit.

Të drejtat e autorit në rregullimin dhe modelin tipografik i takojnë EITI.

Dizajni nga Sue MacDonald.
Shtypur në Paris, qershor 2019.

Sekretariati Ndërkombëtar i EITI
Rådhusgata 26 0151 Oslo Norway
Tel: +47 222 00 800 Website: www.eiti.org E-mail: secretariat@eiti.org

STANDARDI EITI

2019

Standardi global për
qeverisjen e mirë të naftës,
gazit dhe burimeve minerale

SI FUNKSIONON EITI
DHE SI ARRIN NDIKIMIN E TIJ

Grupet kombëtare shumëpalëshe mbikëqyrja e publikimit të të dhënave ...

... **identifikimi i rrezikut të qeverisjes dhe stimulimi i debatit dhe reformave,** bazuar në të dhënat e disponueshme publike.

Të dhënat e besueshme dhe të hapura sigurojnë një **bazë për qeverisje më të mirë,** më shumë investime dhe zhvillim.

Përmbajtja

Parathënie 4

Prezantim 5

KAPITULLI I: ZBATIMI I STANDARDIT EITI 6

1.Parimet EITI 6

2. Si të bëhemi vend zbatues i EITI 7

3. Kërkesat për vendin zbatues të EITI 9

1. Mbikëqyrja nga grupi shumëpalësh 10
2. Kuadri ligjor dhe institucional, duke përfshirë alokimin e kontratave dhe licencave 15
3. Zbulimi dhe prodhimi 21
4. Mbledhja e të ardhurave 22
5. Alokimi i të ardhurave 27
6. Shpenzimet sociale dhe ekonomike 29
7. Rezultatet dhe ndikimi 31

4. Mbikëqyrja nga Bordi i EITI për zbatimin e EITI 34

5. Përmbledhje e Validimit 41

6. Protokolli: Pjesëmarrja e shoqërisë civile 44

7. Pritshmëritë për shoqëritë mbështetëse të EITI 48

8. Politika e të dhënave të hapura 49

KAPITULLI II: QEVERISJA DHE MENAXHIMI 52

9. Akti i Themelimit 53

10. Politika e të dhënave të hapura të EITI 63

11. Udhëzimet a anëtarëve votues të EITI 64

12. Kodi i Sjelljes së Shoqatës EITI 65

Parathënie

Sigurimi i qeverisjes së mirë të industrive nxjerrëse është thelbësor për përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe për luftën kundër korrupsionit. Në dhjetëvjeçarin e kaluar pothuajse 2.5 trilion dollarë nga industritë nxjerrëse janë vënë në dispozicion nga vendet e EITI. Por mbetet edhe më shumë punë për të bërë, veçanërisht në një kohë kur besimi te qeveritë, multilateralizmi, madje edhe vlera e vetë dialogut, janë të gjitha nën tension.

Standardi EITI ka evoluar vazhdimisht që kur u miratuar për herë të parë në vitin 2013. Në atë kohë, mbi 50 vende që e zbatojnë atë i kanë dhënë formë këtij standardi, duke u mbështetur në praktikat në zhvillim në nivel vendi. Ai përcakton standardin global për transparencën dhe llogaridhënien në industritë nxjerrëse dhe është bërë modeli për iniciativat e transparencës të grupit shumëpalësh që punojnë në sektorë të tjerë. Ai vendos në veprim Parimet EITI, ku më kryesori nga të gjithë besimi që ndajnë të gjithë palët e interesit tanë se nga pasuritë e burimeve natyrore të një vendi duhet të përfitojë të gjithë qytetarët e tij. Ky botim përfshin për herë të parë një sërë pritshmërish për shoqëritë që mbështesin EITI dhe që kontribuojnë në objektivat e tij.

Ndryshimi kryesor është se Standardi tani nis nga supozimi se vendet dhe shoqëritë duhet të japin sistematikisht informacionin përmes sistemeve të tyre. Terreni i ri gjithashtu është prishur me kërkesat për këto informacione mbi ndikimet mjedisore, sociale dhe gjinore. Nga ana fiskale dhe ligjore, do të kërkohet transparenca e kontratës për kontratat e reja nga viti 2021 e tutje, dhe tashmë po publikohen të dhënat e reja të shitjes së mallrave dhe raportimi tashmë bëhet në nivel projekti. Një pjesë e mirë e krediteve i detyrohet Bordit të EITI, vendeve zbatuese dhe Sekretariatit Ndërkombëtar të EITI për nxitjen e konsensusit të bazuar në një seri kërkesash të reja që do të vazhdojnë ta bëjnë Standardin e EITI një mjet të dobishëm për reformën.

EITI dhe mbështetësit e tij duhet t'i përgjigjen në mënyrë efikase dhe efektive interesit publik në të ardhurat e sektorit të industrisë nxjerrëse dhe qeverisjen e këtij sektori. Mandati im si Kryetar ka parë një ndryshim të shpejtë në botë, së bashku me peisazhin për transparencën e industrisë nxjerrëse. Perceptimi se ka një mungesë progresi në trajtimin e korrupsionit, evazionit fiskal dhe flukseve të paligjshme financiare ka kontribuar në rritjen e populizmit dhe nacionalizmit ekonomik. Institucionet transparente dhe të forta që nxisin qeverisjen e mirë mbeten mbrojtja dhe mjeti më i mirë kundër kësaj batice.

Fredrik Reinfeldt, Kryetar i Bordit të EITI 2016-2019
17 qershor 2019

Hyrje

Standardi EITI përbëhet nga ky kapituj: kapitulli i parë, *Zbatimi i Standardit EITI*; dhe kapitulli i dytë, *Qeverisja dhe Menaxhimi.*

Kapitulli i parë, *Zbatimi i Standardit EITI*, përfshin:

- **Parimet EITI**, të miratuara nga të gjitha palët e interesit në vitin 2003. Këto Parime përcaktojnë qëllimet dhe angazhimet e përgjithshme nga të gjithë palët e interesit.
- **Kërkesat e EITI**, të cilat duhet të respektohen nga të gjitha vendet që zbatojnë EITI.
- Seksioni për **Mbikëqyrja nga Bordi i EITI për zbatimin e EITI**, i cili përshkruan afatet kohore që vendet zbatuese duhet të respektojnë dhe pasojat e mosrespektimit të Kërkesave të EITI.
- **Përmbledhje e validimit** Validimi u siguron palëve të interesit një vlerësim të paanshëm të progresit në zbatimin e EITI drejt përmbushjes së kërkesave të Standardit EITI.
- **Protokolli "Pjesëmarrja e shoqërisë civile",** i cili përcakton kërkesat dhe pritshmëritë në lidhje me pjesëmarrjen e shoqërisë civile në zbatimin e EITI.
- **Pritshmëritë për shoqëritë mbështetëse të EITI**
- **Politika e të dhënave të hapura.**

Udhëzimet për pjesën e parë të Standardit EITI janë të disponueshme në faqen e internetit eiti.org/guide.

Kapitulli i dytë trajton *Qeverisjen dhe Menaxhimin e EITI.* Përfshihen: **Akti i Themelimit**, ku trajtohet se si Shoqata e Anëtarëve të EITI qeveriset nga **politika e të dhënave të hapura të EITI** , ku trajtohet se si vetë EITI duhet të jetë transparent. Çdo anëtar votues i Shoqatës ka rënë dakord **Udhëzimet e anëtarëve votues**. Këtu përfshihet gjithashtu edhe **Kodi i Sjelljes së Shoqatës EITI,** i cili përcakton pritshmëritë për sjelljen për të gjithë anëtarët e bordit të EITI, zëvendësit e tyre, anëtarët e shoqatës EITI, personelin e sekretariatit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe anëtarët e grupeve shumëpalëshe.

KAPITULLI I
Zbatimi i Standardit EITI

1.Parimet EITI

Një larmi vendesh, shoqërish dhe organizatash të shoqërisë civile morën pjesë në Konferencën e Lancaster House në Londër (2003) e organizuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Ata ranë dakord për një Deklaratë të Parimeve për të rritur transparencën mbi pagesat dhe të ardhurat në sektorin e industrisë nxjerrëse. Këto u bënë të njohura si Parimet EITI dhe përbëjnë një gur themeli të EITI.

Kutia 1 – Parimet EITI

1 Ne ndajmë besimin se përdorimi i matur i pasurive të burimeve natyrore duhet të jetë një motor i rëndësishëm lëvizës për rritjen e qëndrueshme ekonomike që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë, por nëse nuk menaxhohet si duhet, mund të krijojë ndikime negative në ekonomi dhe shoqëri.

2 Ne konfirmojmë se menaxhimi i pasurive të burimeve natyrore për të mirën e qytetarëve të një vendi është në domenin e qeverive sovrane në mënyrë që të ushtrohet në interes të zhvillimit të tyre kombëtar.

3 Ne pranojmë që përfitimet e industrisë nxjerrëse të burimeve natyrore ndodhin si rrjedha të ardhurash për shumë vite dhe mund të varen shumë nga çmimi.

4 Ne pranojmë që një mirëkuptim publik i të ardhurave dhe shpenzimeve të qeverisë me kalimin e kohës mund të ndihmojë debatin publik dhe të informojë zgjedhjen e opsioneve të përshtatshme dhe reale për një zhvillim të qëndrueshëm.

5 Ne nënvizojmë rëndësinë e transparencës nga qeveritë dhe shoqëritë në industritë nxjerrëse dhe nevojën për të rritur menaxhimin e financave publike dhe llogaridhënien.

6 Ne pranojmë që duhet të vendoset një transparencë më e madhe në kontekstin e respektimit të kontratave dhe ligjeve.

7 Ne konfirmojmë se një mjedis më i mirë për investime të drejtpërdrejta vendase dhe të huaja mund të sjellë transparenca financiare.

8 Ne besojmë në parimin dhe praktikën e përgjegjësisë nga qeveria për të gjithë qytetarët për administrimin e rrjedhave të të ardhurave dhe shpenzimeve publike.

9 Ne jemi të përkushtuar për të inkurajuar standarde të larta të transparencës dhe llogaridhënies në jetën publike, operacionet qeveritare dhe në biznes.

10 Ne besojmë se nevojitet një qasje gjerësisht e qëndrueshme dhe e zbatueshme për zbulimin e pagesave dhe të ardhurave, e cila duhet të jetë e thjeshtë për tu ndërmarrë dhe për t'u përdorur.

11 Ne besojmë se publikimi i pagesave në një vend të caktuar duhet të përfshijë të gjitha shoqëritë e industrisë nxjerrëse që operojnë në atë vend.

12 Gjatë kërkimit të zgjidhjeve të duhura, ne besojmë se të gjithë palët e interesit mund të japin një kontribut të rëndësishëm, duke përfshirë qeveritë dhe agjencitë e tyre, shoqëritë e industrisë nxjerrëse, shoqëritë e shërbimeve, organizatat shumëpalëshe, organizatat financiare, investitorët dhe organizatat joqeveritare.

2. Si të bëhemi vend zbatues i EITI

Një vendi që synon të zbatojë EITI duhet të ndërmarrë një disa hapa përpara se të aplikojë për t'u bërë një vend EITI. Këto hapa lidhen
me angazhimin e qeverisë (1.1), angazhimin e shoqërisë (1.2), angazhimi i shoqërisë civile (1.3), krijimin e një grupi shumëpalësh (1.4) dhe marrëveshjen për një plan pune EITI (1.5). Në faqet 10-14 janë paraqitur disa dispozitat e hollësishme. Kur vendi të ketë plotësuar këto hapa dhe dëshiron të njihet si një vend zbatues i EITI, qeveria duhet të depozitojë një Aplikim EITI tek Bordi i EITI (shih kutinë 2).

Kutia 2 – Si të bëheni vend zbatues i EITI

Kur vendi të ketë plotësuar të gjitha hapat e regjistrimit dhe dëshiron të njihet si një vend zbatues i EITI, qeveria duhet të depozitojë një Aplikim EITI, të miratuar nga grupi shumëpalësh. 1 Aplikimi duhet të përshkruajë aktivitetet e ndërmarra deri më atë moment dhe të sigurojë
prova që dëshmojnë se secili nga hapat e regjistrimit ka përfunduar. Aplikimi duhet të përfshijë të dhënat e kontaktit për qeverinë, shoqërinë civile dhe palët e interesit të sektorit privat të përfshirë në EITI.

Pasi të depozitohet, aplikimi do të bëhet i disponueshëm për publikun në faqen e internetit të EITI. Bordi i EITI do të shqyrtojë aplikimin dhe do të vlerësojë nëse hapat e regjistrimit janë plotësuar si duhet. Sekretariati Ndërkombëtar do të punojë ngushtë me personin përgjegjës të emëruar nga qeveria për të udhëhequr zbatimin e EITI në mënyrë që të sqarojë çdo çështje të pazgjidhur. Bazuar në këtë dhe çdo informacion tjetër të disponueshëm, Komiteti i Informimit dhe Kandidaturave të Bordit EITI do t'i bëjë një rekomandim Bordit të EITI, brenda një periudhe kohe të arsyeshme, nëse aplikimi i një vendi duhet të pranohet. Bordi EITI do të marrë vendimin përfundimtar.

Bordi i EITI synon të përpunojë aplikimet brenda tetë javësh nga marrja e aplikimit. Bordi i EITI preferon të marrë vendime për pranimin e një vendi EITI gjatë mbledhjeve të Bordit të EITI, megjithëse mund të marrë në konsideratë marrjen e një vendimi përmes një qarkoreje të Bordit të nxjerrë gjatë këtyre takimeve, kur kjo është e përshtatshme.

Kur Bordi i EITI pranon një vend zbatues të EITI, ai do të përcaktojë gjithashtu afatet për botimin e Raportit të parë të EITI dhe Validimin e tij. Procesi i transparencës sipas standardeve të EITI të një vendi zbatues duhet të bëhen të disponueshme brenda
18 muaj nga data e pranimit të vendit. Validimi do të nisë brenda dy vitesh e gjysmë pasi vendi të jetë shpallur vend zbatues i EITI. Informacione të mëtejshme mbi raportimin dhe afatet e vlerësimit, dhe hapësirat për zgjatjen e këtyre afateve, përshkruhen në seksionin 4 për mbikëqyrjen e bordit të EITI mbi zbatimin e EITI.

VAZHDON

1 Sekretariati Ndërkombëtar ka vendosur në dispozicion një formular të standardizuar aplikimi.

2. Si të bëhemi vend zbatues i EITI Vazhdon

Vendet që përgatiten të bashkohen me EITI inkurajohen të identifikojnë pengesat e mundshme për publikimet sistematike që nga fillimi i procesit, për shembull duke kryer një studim fizibiliteti të zbulimit sistematik ose duke trajtuar mundësi për publikime sistematike si pjesë e përgatitjeve për t'u bërë një vend zbatues i EITI.

3. Kërkesat për vendet zbatuese të EITI

Ky seksion përcakton kërkesat që duhet të respektohen nga vendet zbatuese të EITI.

Kërkesat e EITI janë kërkesa minimale dhe vendet zbatuese inkurajohen të shkojnë përtej tyre kur palët e interesit bien dakord që kjo është e përshtatshme. Palët e interesit inkurajohen të konsultohen me materiale shtesë udhëzuese se si të bëjnë të mundur që kërkesat të përmbushen, informacioni i disponueshëm në faqen eiti.org/guide.

Terminologjia

Përdorimi i termave **"duhet"**, **"do të"** dhe **"kërkohet"** në Standardin EITI tregojnë se diçka konsiderohet **e detyrueshme** dhe do të merret parasysh gjatë vlerësimit të përputhshmërisë me Standardin EITI.

Përdorimi i termit **"pritet"** në Standardin EITI tregon se grupi shumëpalësh duhet të **marrë në konsideratë këtë çështje** dhe të dokumentojnë diskutimet, arsyetimet e tyre për publikimin/ mospublikimin dhe çdo pengesë për mospublikim. Validimi do të marrë në konsideratë dhe dokumentojë diskutimet nga grupi shumëpalësh.

Përdorimi i termave **"rekomandohet"**, **"inkurajohet"**, **"dëshiron"** dhe **"mund"** në Standardin EITI tregon se diçka është **opsionale**. Përpjekjet nga grupi shumëpalësh do të dokumentohen në procesin e Validimit por nuk do të merren parasysh në vlerësimin e përgjithshëm të përputhshmërisë me Standardin EITI.

Termat **"publikim sistematik"** dhe **"përfshirje"** përdoren në mënyrë të ndërvepruesshme. Ato i referohen gjendjes përfundimtare të dëshiruar, ku plotësohen kërkesat e publikimit të EITI përmes **raportimeve rutinë dhe të disponueshme për publikun nga shoqëria dhe qeveria.** Këtu mund të përfshihet raportimi financiar publik, raportet vjetore, portalet e informacionit dhe iniciativat e tjera të të dhënave të hapura. Publikimi sistematik është kur pritet që, me Raportet EITI të përdorura për të siguruar kontekst shtesë, të mblidhen burimet ku mund të gjenden publikime sistematike dhe të trajtohet çdo mangësi dhe shqetësim në lidhje me cilësinë e të dhënave. Kërkesat e publikimeve të EITI mund të përmbushen duke iu referuar informacionit në dispozicion të publikut dhe/ose të dhënave të mbledhura si pjesë e zbatimit të EITI.

KËRKESA 1

Mbikëqyrja nga grupi shumëpalësh.

PËRMBLEDHJE: EITI kërkon mbikëqyrje efektive të palëve të interesit, duke përfshirë një grup funksional shumëpalësh që përfshin qeverinë, shoqëritë dhe pjesëmarrjen e plotë, të pavarur, aktive dhe efektive të shoqërisë civile. Kërkesat kryesore në lidhje me mbikëqyrjen grupit shumëpalësh përfshijnë: (1.1) angazhimin e qeverisë; (1.2) angazhimin e shoqërisë; (1.3) angazhimin e shoqërisë civile; (1.4) krijimin dhe funksionimin e një grupi shumëpalësh; dhe (1.5) një plan pune të miratuar me objektiva të qarta për zbatimin e EITI dhe një kalendar kohor që përputhet me afatet e përcaktuara nga Bordi EITI.

1.1 Angazhimi i qeverisë.

a) Qeverisë i kërkohet të lëshojë një deklaratë publike të qartë për qëllimin e saj për të zbatuar EITI. Deklarata duhet të bëhet nga kreu i shtetit ose qeveria, ose një përfaqësues i qeverisë i deleguar në mënyrë të përshtatshme.

b) Qeverisë i kërkohet të caktojë një individ në nivel të lartë për të udhëhequr zbatimin e EITI. I emëruari duhet të ketë besimin e të gjithë palëve të interesit, autoritetin dhe lirinë për të koordinuar veprimet mbi EITI nëpër ministritë dhe agjencitë përkatëse, dhe të jetë në gjendje të mobilizojë burimet për zbatimin e EITI.

c) Qeveria duhet të angazhohet plotësisht, në mënyrë aktive dhe efektive në procesin EITI.

d) Qeveria duhet të sigurojë që zyrtarët e lartë qeveritarë të përfaqësohen në grupin shumëpalësh.

1.2 Angazhimi i qeverisë.

a) Shoqëritë duhet të angazhohen plotësisht, në mënyrë aktive dhe efektive në procesin EITI.

b) Qeveria duhet të sigurojë që ekziston një mjedis mundësues për pjesëmarrjen e shoqërisë në lidhje me ligjet, rregulloret dhe rregullat administrative përkatëse, si dhe praktikën aktuale në zbatimin e EITI. Duhet të respektohen të drejtat themelore të përfaqësuesve të shoqërive të përfshira në mënyrë thelbësore në EITI, duke përfshirë por pa u kufizuar me anëtarët e grupit shumëpalësh.

c) Qeveria duhet të garantojë që të mos ketë pengesa për pjesëmarrjen e shoqërisë në procesin EITI.

KËRKESA 1 Vazhdon

1.3 Angazhimi i shoqërisë civile.

Në përputhje me protokollin e shoqërisë civile: 2

a) Shoqëria civile duhet të angazhohet plotësisht, në mënyrë aktive dhe efektive në procesin EITI.

b) Qeveria duhet të sigurojë që ekziston një mjedis mundësues për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në lidhje me ligjet, rregulloret dhe rregullat administrative përkatëse, si dhe praktikën aktuale në zbatimin e EITI. Duhet të respektohen të drejtat themelore të shoqërisë civile të përfshira në mënyrë thelbësore në EITI, duke përfshirë por pa u kufizuar me anëtarët e grupit shumëpalësh.

c) Qeveria duhet të sigurojë që të mos ketë pengesa për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin EITI.

d) Qeveria duhet të përmbahet nga veprimet që ngushtojnë ose kufizojnë debatit publik në lidhje me zbatimin e EITI.

e) Palët e interesit, duke përfshirë por pa u kufizuar me anëtarët e grupit shumëpalësh, duhet:

   i. Të jetë në gjendje të flasin lirshëm për transparencën dhe çështjet e qeverisjes së burimeve natyrore.

   ii. Të jenë të angazhuar në mënyrë thelbësore në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit EITI, dhe të sigurohen që ai të kontribuojë në debatin publik.

   iii. Të kenë të drejtë të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

   iv. Të jetë në gjendje të veprojnë lirshëm dhe të shprehin mendime rreth EITI pa u kufizuar, pa krijuar barriera ose masa disiplinore.

1.4 Grupi shumëpalësh.

a) Qeverisë i kërkohet të angazhohet për të punuar me shoqërinë civile dhe shoqëritë dhe të krijojë një grup shumëpalësh për të mbikëqyrur zbatimin e EITI. Për krijimin e grupit shumëpalësh, qeveria duhet:

   i. Të sigurojë që ftesa për të marrë pjesë në grup të jetë e hapur dhe transparente.

   ii. Të sigurojë që palët e interesit të përfaqësohen në mënyrën e duhur. Kjo nuk do të thotë që ata duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë sa i përket numrave. Grupi shumëpalësh duhet të përbëhet nga palët e duhura të interesit,
   përfshirë por pa u kufizuar domosdoshmërish nga: sektori privat; shoqëria civile, duke përfshirë grupet e pavarura të shoqërisë civile dhe shoqërinë tjetër civile siç janë media dhe sindikatat; dhe entet përkatëse qeveritare, të cilat mund të përfshijnë edhe parlamentarë. Secili grup i palëve të interesit duhet të ketë të drejtën të caktojë përfaqësuesit e vet, duke pasur parasysh dëshirën

2 Protokolli i shoqërisë civile përshkruhet në **seksionin 6** të standardit EITI.

KËRKESA 1.4 Vazhdon

e përfaqësimit pluralist dhe të larmishëm. Procesi i emërimit duhet të jetë i pavarur dhe i lirë nga çdo sugjerim me forcë. Grupet e shoqërisë civile të përfshira në EITI si anëtarë të grupit shumëpalësh duhet të jenë i pavarur në nivel operacional dhe politike, nga qeveria dhe/ose ndërmarrjet. Grupi shumëpalësh dhe secili anëtar votues duhet të marrin në konsideratë ekuilibrin gjinor në përfaqësimin e tyre për të përparuar drejt barazisë gjinore.

iii. Të marrë parasysh krijimin e bazës ligjore të grupit.

b) Grupit shumëpalësh u kërkohet të bien dakord që Kushtet e Referencës (ToRs) për punën e tyre të jenë të qarta për publikun. Kushtet e Referencës duhet, të paktën, të përfshijnë dispozita për:

Roli, përgjegjësitë dhe të drejtat e grupit shumëpalësh:

i. Anëtarët e grupit shumëpalësh duhet të kenë aftësinë të kryejnë detyrat e tyre.

ii. Grupi shumëpalësh duhet të ndërmarrë veprimtari efektive në terren me grupet e shoqërisë civile dhe shoqëritë, duke përfshirë përmes komunikimit, të tilla si media, faqet e internetit dhe letrat, informimin e palëve të interesit për angazhimin e qeverisë për të zbatuar EITI, dhe rolin qendror të shoqërive dhe shoqërisë civile. Grupi shumëpalësh duhet gjithashtu të shpërndajë informacionin publik që rezulton nga procesi EITI.

iii. Anëtarët e grupit shumëpalësh duhet të ndërlidhen me grupet e tyre të anëtarëve votues.

iv. Anëtarët e grupit shumëpalësh pritet të respektojnë Kodin e Sjelljes së Shoqatës EITI.

Miratimi i planeve të punës dhe mbikëqyrja e zbatimit:

v. Grupit shumëpalësh u kërkohet të miratojnë planet vjetore të punës në përputhje me Kërkesën 1.5.

vi. Grupi shumëpalësh duhet të mbikëqyrë procesin e raportimit EITI dhe të angazhohet në Vlerësimin.

Rregullat dhe procedurat e qeverisjes së brendshme:

vii. EITI kërkon një proces vendimmarrës gjithëpërfshirës gjatë gjithë zbatimit, ku secili anëtar votues të trajtohet si partner. Çdo anëtar i grupit shumëpalësh ka të drejtë të paraqesë një çështje për diskutim. Grupi shumëpalësh duhet të jetë dakord dhe të publikojë procedurat e tij për emërimin dhe ndryshimin e përfaqësuesve të grupeve shumëpalëshe, për vendimmarrjen, kohëzgjatjen e mandatit dhe shpeshtësinë e takimeve. Kjo duhet të sigurojë se ekziston një proces për ndryshimin e anëtarëve të grupit që respekton parimet e përcaktuara në Kërkesën 1.4 (a). Kur grupi shumëpalësh ushtron një praktikë dietash për të marrë pjesë në takimet e EITI, ose gëzon pagesa të tjera për anëtarët e saj, kjo praktikë duhet të jetë transparente dhe nuk duhet të krijojë konflikte interesi.

KËRKESA 1.4 Vazhdon

viii. Njoftimi duhet të jepet mjaftueshëm në kohë për zhvillimin e takimeve dhe qarkullimin në kohë të dokumenteve para debatit dhe miratimit të propozuar.

ix. Grupi shumëpalësh duhet të mbajë shënime me shkrim për diskutimet dhe vendimet e tij.

1.5 Plani i punës.

Grupit shumëpalësh i kërkohet të mbajë një plan pune aktual, i cili të përfshijë të gjitha kostot dhe të jetë i harmonizuar me afatet e Raportimit dhe Validimit të përcaktuara nga Bordi EITI. Plani i punës duhet:

a) Përcaktojë objektivat e zbatimit të EITI që janë të lidhura me Parimet EITI dhe të pasqyrojë përparësitë kombëtare për industritë nxjerrëse. Grupi shumëpalësh duhet të trajtojë hapat e nevojshëm për të përfshirë zbatimin e EITI në sistemin e shoqërive dhe qeverisë. Grupet shumëpalëshe
inkurajohen të eksplorojnë qasje novatore për shtrirjen e zbatimit EITI për të informuar debatin publik për qeverisjen e burimeve natyrore dhe për të inkurajuar standarde të larta të transparencës dhe llogaridhënies në jetën publike, operacionet e qeverisë dhe në biznes.

b) Të reflektojë rezultatet e konsultimeve me palët kryesore të interesit dhe të mbështetet nga grupi shumëpalësh.

c) Të përfshijë aktivitete të matshme dhe të kufizuara në kohë për të arritur objektivat e rënë dakord. Fusha e zbatimit të EITI duhet të përshtatet në mënyrë të tillë që të kontribuojë në objektivat e dëshiruar të identifikuara gjatë procesit të konsultimit. Plani i punës duhet:

   i. Të vlerësojë dhe përshkruajë planet për të trajtuar çdo kufizim të mundshëm të kapaciteteve të agjencive qeveritare, shoqërive dhe shoqërisë civile që mund të jenë pengesë për zbatimin efektiv të EITI.

   ii. Të trajtojë fushën e zbatimit të EITI, duke përfshirë planet për forcimin e publikimeve sistematike dhe trajtimin e aspekteve teknike të raportimit, siç janë gjithëpërfshirja dhe besueshmëria e të dhënave (4.1 dhe 4.9).

   iii. Të identifikojë dhe përshkruajë planet për të trajtuar çdo pengesë të mundshme ligjore ose rregullatore për zbatimin e EITI, duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, çdo plan
   për të përfshirë Kërkesat EITI në përbërje të legjislacionit ose rregulloreve kombëtare.

   iv. Të përmbledhë planet e grupit shumëpalësh për zbatimin e rekomandimeve nga zbatimi dhe Validimi i EITI.

   v. Të përshkruajë planet për zbulimin e kontratave në përputhje me Kërkesën 2.4 (b) dhe informacionin e përfituesit të pronësisë në përputhje me Kërkesën 2.5 (c) - (f), duke përfshirë arritjet kryesore dhe afatet.

d) Të identifikojë burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit dhe asistencës teknike, kur është e përshtatshme, për të siguruar zbatimin në kohë të planit të miratuar punës.

3. Kërkesat për vendin zbatues të EITI Vazhdon

KËRKESA 1.5 Vazhdon

e) Të vendoset në dispozicion të publikut, për shembull i botuar në faqen e internetit kombëtare të EITI dhe/ose në faqet e tjera të ministrive dhe agjencive përkatëse, në media të shkruara ose në vende që janë lehtësisht të aksesueshme për publikun.

f) Të rishikohet dhe përditësohet çdo vit. Gjatë rishikimit të planit të punës, grupi shumëpalësh duhet të marrë në konsideratë shtrirjen e detajeve dhe qëllimit të zbatimit të EITI. Në përputhje me Kërkesën 1.4 (b), grupit shumëpalësh e kërkohet të dokumentojë diskutimet dhe vendimet e tij.

g) Ai duhet të përfshijë një afat kohor për zbatimin që përputhet me afatet e përcaktuara nga Bordi EITI (Seksioni 4 - Mbikëqyrja nga Bordi i EITI për zbatimin e afateve EITI) dhe që merr parasysh kërkesat administrative të tilla si proceset e prokurimit dhe financimin.

KËRKESA 2

Kuadri ligjor dhe institucional, duke përfshirë alokimin e kontratave dhe licencave.

PËRMBLEDHJE: EITI kërkon dhënie informacioni mbi mënyrën e menaxhimit të sektorit të industrisë nxjerrëse, duke u mundësuar palëve të interesit të kuptojnë ligjet dhe procedurat për dhënien e të drejtave të kërkimit dhe prodhimit, kuadrin ligjor, rregullator dhe kontraktual që zbatohet për sektorin e nxjerrjes dhe përgjegjësitë institucionale të Shtetit në menaxhimin e sektorit. Kërkesat EITI në lidhje me një kuadër ligjor transparent dhe dhënien e të drejtave të industrisë nxjerrëse përfshijnë: (2.1) kuadrin ligjor dhe regjimin fiskal; (2.2) alokimet e kontratës dhe licencës; (2.3) regjistrin e licencave; (2.4) kontratat; (2.5) pronësinë përfituese; dhe (2.6) pjesëmarrjen e shtetit në sektorin e industrisë nxjerrëse.

2.1 Kuadri ligjor dhe regjimi fiskal.

a) Vendet zbatuese duhet të publikojnë një përshkrim të kuadrit ligjor dhe regjimit fiskal që rregullon industritë nxjerrëse. Ky informacion duhet të përfshijë një përshkrim përmbledhës të regjimit fiskal, duke përfshirë nivelin e transferimit fiskal, një përmbledhje të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, një përshkrim të llojeve të ndryshme të kontratave dhe licencave që rregullojnë kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve dhe informacione mbi rolet dhe përgjegjësitë e agjencive përkatëse qeveritare.

b) Kur qeveria ndërmerr reforma, grupi shumëpalësh inkurajohet të garantojë që këto reforma të jenë të dokumentuara.

2.2 Dhënia e kontratave dhe licencave.

a) Vendeve zbatuese u kërkohet të japin informacionin e mëposhtëm në lidhje me të gjitha kontratat dhe licencat e dhëna dhe transferimet që ndodhin gjatë periudhës kontabël të mbuluar nga publikimet më të fundit të EITI, duke përfshirë shoqëritë pagesa e të cilave bie nën pragun e rënë dakord të materiales:

   i. Një përshkrim i procesit për transferimin ose dhënien e licencës;

   ii. Kriteret teknike dhe financiare të përdorura;

   iii. Informacion në lidhje me marrësin(et) e licencës që është transferuar ose dhënë, duke përfshirë anëtarët e konsorciumit, kur është e zbatueshme; dhe

   iv. Çdo devijim material nga kuadri ligjor dhe rregullativ i zbatueshëm që rregullon transferimet dhe dhëniet e licencave.

   Në rastet kur qeveritë mund të zgjedhin metoda të ndryshme për dhënien e një kontrate ose licence (p.sh. oferta konkurruese ose negociata të drejtpërdrejta), përshkrimi i procesit për dhënien ose transferimin e një licence mund të përfshijë një shpjegim të rregullave që përcaktojnë se cila procedurë duhet të përdoret dhe pse është zgjedhur një procedurë e veçantë.

KËRKESA 2.2 a) Vazhdon

Kur ka mangësi informacioni të disponueshëm për publikun, këto duhet të identifikohen qartë. Çdo pengesë e konsiderueshme ligjore ose praktike që parandalon publikimin gjithëpërfshirës të informacionit të paraqitur më sipër duhet të dokumentohet dhe shpjegohet, duke përfshirë planet e qeverisë për të kapërcyer pengesat e tilla dhe afatet kohore të parashikuara për arritjen e tyre.

b) Kur shoqëritë kanë licenca që janë dhënë para periudhës së mbuluar nga zbatimi i EITI, vendet zbatuese inkurajohen të japin informacionin e paraqitur në 2.2 (a).

c) Kur licencat jepen përmes një procesi oferte, qeverisë i kërkohet të publikojë listën e aplikantëve dhe kriteret e ofertës.

d) Grupi shumëpalësh mund të dëshirojë të përfshijë informacione shtesë mbi shpërndarjen e licencave si pjesë e publikimeve të EITI. Kjo mund të përfshijë komente mbi efikasitetin dhe efektivitetin e procedurave të licencimit, dhe një përshkrim të procedurave, praktikave aktuale dhe arsyeve për rinovimin, pezullimin ose revokimin e një kontrate ose licence.

2.3 Regjistri i licencave.

a) Termi "licencë" në këtë kontekst i referohet çdo licence, qiraje, titulli, leje, kontrate ose koncesioni me të cilin qeveria i jep një shoqërie(ve) ose individi(ve) të drejta për të eksploruar ose shfrytëzuar burimet e naftës, gazit dhe/ose mineraleve.

b) Vendeve zbatuese u kërkohet të mbajnë një regjistër ose sistem kadastral të disponueshëm për publikun me informacionin vijues në kohë dhe gjithëpërfshirës në lidhje me secilën nga licencat që u përkasin shoqërive brenda fushës së miratuar të zbatimit të EITI:

   i. Titullari(t) i licencës.

   ii. Kur të mblidhen, duhet të jepen koordinatat e zonës së licencës. Nëse këto koordinata nuk janë mbledhur, qeverisë i kërkohet të sigurojë që madhësia dhe vendndodhja e zonës së licencës të paraqitet në regjistrin e licencës dhe koordinatat të vendosen në dispozicion të publikut nga agjencia përkatëse qeveritare pa tarifa dhe kufizime të paarsyeshme. Këto informacione duhet të përfshijnë udhëzime se si të aksesohen koordinatat dhe gjithashtu të jepet informacion, nëse ka, për aksesin në këto të dhëna. Qeveria gjithashtu duhet të dokumentojë planet dhe afatet kohore për ta vendosur këtë informacion në dispozicion pa pagesë dhe në formë elektronike përmes regjistrit të licencës.

   iii. Data e aplikimit, data e lëshimit dhe kohëzgjatja e licencës.

   iv. Në rastin e licencave të prodhimit, është malli që prodhohet.

   Pritet që regjistri i licencave ose kadastra të përfshijë informacione në lidhje me licencat që kanë të gjitha njësitë, duke përfshirë shoqëritë dhe individët ose grupet që janë jashtë fushës së rënë dakord të zbatimit të EITI, d.m.th. kur pagesat e tyre bien nën pragun e rënë dakord të materiales. Çdo pengesë e konsiderueshme ligjore ose praktike që parandalon publikimin gjithëpërfshirës të informacionit duhet të dokumentohet dhe shpjegohet, duke përfshirë planet e qeverisë për të kapërcyer pengesa të tilla dhe afatet kohore të parashikuara për arritjen e tyre.

KËRKESA 2.3 Vazhdon

c) Kur këto regjistra ose kadastra nuk ekzistojnë ose janë të paplota, duhet të jepet informacion për çdo mungesë informacioni të disponueshëm publik dhe të dokumentohen përpjekjet për forcimin e këtyre sistemeve.

2.4 Kontratat.

a) Vendeve zbatuese u kërkohet të japin informacion për çdo kontratë dhe licencë që jepet, lidhet ose ndryshohet nga 1 Janari 2021. Vendet zbatuese inkurajohen të japin informacion për çdo kontratë dhe licencë që garanton kushtet e bashkangjitura në shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve.

b) Grupi shumëpalësh pritet të miratojë dhe të publikojë një plan për publikimin e kontratave me një afat të qartë kohor për zbatimin dhe trajtimin e çdo pengese për publikimin e plotë. Ky plan do të integrohet në planet e punës që mbulojnë vitin 2020 e tutje.

c) Kërkohet që të dokumentohet politika e qeverisë për dhënien e informacionit në lidhje me kontratat dhe licencat që rregullojnë kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. Kjo duhet të përfshijë:

   i. Një përshkrim nëse legjislacioni ose politika e qeverisë trajton çështjen e publikimit të kontratave dhe licencave, duke përfshirë nëse kërkon ose ndalon publikimin e këtyre kontratave dhe licencave. Nëse legjislacioni në fjalë nuk ekziston, një shpjegim mbi politikat qeveritare ku është përfshirë çështja duhet mundësuar. Ndërkohë edhe grupi shumë-palësh përkatës duhet të dokumentojë diskutimin e tij mbi përmbajtjen e politikës qeveritare në lidhje me publikimin e kontratave. Çdo reformë që lidhet me publikimin e kontratave dhe licencave të planifikuara ose në proces, duhet të dokumentohet.

   ii. Përmbledhjet e kontratave dhe licencave në dispozicion të publikut. Vendet zbatuese duhet të sigurojnë një listë të të gjitha kontratave dhe licencave aktive, duke treguar se cilat janë në dispozicion të publikut dhe cilat jo. Për të gjitha kontratat dhe licencat e bëra publike, duhet të vendoset një referencë ose lidhje me vendin ku është publikuar kontrata ose licenca. Në rast se një kontratë ose licencë nuk është bërë publike, pengesat ligjore ose praktike duhet të dokumentohen dhe shpjegohen.

   iii. Kur deklarimet devijojnë nga kërkesat legjislative ose të politikave qeveritare përkatëse, duhen dhënë shpjegimet përkatëse.

d) Termi “kontratë” në 2.4 (a) do të thotë:

   i. Teksti i plotë i çdo kontrate, koncesioni, marrëveshje për ndarjen e prodhimit ose marrëveshje tjetër të dhënë nga, ose e lidhur nga, qeveria e cila siguron kushtet bashkëlidhur në shfrytëzimin e naftës, gazit dhe burimeve minerale.

KËRKESA 2.4 d) Vazhdon

ii. Teksti i plotë i çdo shtojce, shtese ose aneksi që përcakton detaje të rëndësishme për të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 2.4 (d) (i) ose ekzekutimin e tyre.

iii. Teksti i plotë i çdo modifikimi ose ndryshimi në dokumentet e përshkruara në 2.4 (d) (i) dhe 2.4 (d) (ii).

e) Termi "licencë" në 2.4 (a) do të thotë:

i. Teksti i plotë i çdo licence, qiraje, titulli ose leje me të cilën një qeveri i jep një shoqërie(ve) ose individi(ve) të drejta për të shfrytëzuar naftën, gazin dhe/ose burimet minerale.

ii. Teksti i plotë i çdo shtojce, shtese ose aneksi që përcakton detaje të rëndësishme për të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 2.4 (e) (i) ose ekzekutimin e tyre.

iii. Teksti i plotë i çdo modifikimi ose ndryshimi në dokumentet e përshkruara në 2.4 (e) (i) dhe 2.4 (e) (ii).

2.5 Pronësia përfituese.

a) Rekomandohet që vendet zbatuese të mbajnë një regjistër të disponueshëm për publikun të pronarëve përfitues të njësisë së korporatës(ve) që aplikojnë ose mbajnë një interes pjesëmarrës në një kërkim ose prodhim të licencës ose kontratës së naftës, gazit ose minierave, duke përfshirë identitetin(et) e pronarit(ve) përfitues të tyre, nivelin e pronësisë dhe detajet rreth mënyrës se si ushtrohet pronësia ose kontrolli. Kur është e mundur, informacioni për pronësinë përfituese duhet të përfshihet në dokumentet ekzistuese nga shoqëritë për rregullatorët e korporatave, bursat ose agjencitë që rregullojnë licencimin e industrisë nxjerrëse. Kur ky informacion është vendosur më parë në dispozicion të publikut, Raporti EITI duhet të përmbajë udhëzime se si të përdoret ky informacion.

b) Vendeve zbatuese u kërkohet të dokumentojnë politikën e qeverisë dhe diskutimin e grupit shumëpalësh mbi publikimin pronësisë
përfituese. Këtu duhet të përfshihen detaje të dispozitave përkatëse ligjore, praktikat aktuale të dhënies së informacionit dhe çdo reformë që është planifikuar ose është duke u zhvilluar në lidhje me informacionet për pronësinë përfituese.

c) Që nga 1 janari 2020, kërkohet që vendet zbatuese të kërkojnë, dhe shoqëritë të publikojnë informacione lidhur me pronësinë përfituese. Kjo vlen për entitetet(et) e korporatave që aplikojnë ose mbajnë një interes pjesëmarrës në një kërkim ose prodhim të licencës ose kontratës së naftës, gazit ose minierave dhe duhet të përfshijë identitetin(et) e pronarit(eve) të tyre përfitues, nivelin e pronësisë dhe detaje rreth mënyrës se si ushtrohet pronësia ose kontrolli. Duhet të publikohet çdo mangësi ose dobësi e konsiderueshme në raportimin e informacionit mbi pronësinë përfituese, duke përfshirë emërtimin e njësive ekonomike që nuk kanë arritur të paraqesin të gjithë ose pjesët e
informacionit të pronësisë përfituese. Kur një vend përballet me barriera kushtetuese ose praktike të rëndësishme për zbatimin e kësaj kërkese
deri më 1 janar 2020, vendi mund të kërkojë zbatim të përshtatur në përputhje me nenin 1 të procedurave të Bordit të EITI për mbikëqyrjen e zbatimit të EITI në Seksionin 4.

KËRKESA 2.5 Vazhdon

d) Informacioni në lidhje me identitetin e pronarit përfitues duhet të përmbajë emrin e pronarit përfitues, kombësinë e tyre dhe vendin e tyre të banimit, si dhe identifikimin e personave të ekspozuar politikisht. Rekomandohet gjithashtu që të jepet informacion për numrin e tyre të identitetit kombëtar, datën e lindjes, vendin e rezidencës ose adresën e shërbimit dhe mjetet e kontaktit.

e) Grupi shumëpalësh duhet të vlerësojë çdo mekanizëm ekzistues për të siguruar besueshmërinë e informacionit të pronësisë përfituese dhe të bien dakord për një qasje për entitetet e korporatave brenda objektit të 2.5(c) për të siguruar saktësinë e informacionit përfitues të pronësisë që ata ofrojnë. Kjo përfshin që shoqëritë të vërtetojnë formularin e deklarimit të pronësisë përfituese përmes nënshkrimit nga një anëtar i ekipit të stafit drejtues ose këshilltarit të vjetër ligjor, ose të paraqesin dokumentacionin mbështetës.

f) Përkufizimi i pronësisë përfituese:

   i. Një pronar përfitues në lidhje me një shoqëri nënkupton personin (personat) fizikë që drejtpërdrejt ose tërthorazi zotërojnë ose kontrollojnë njësinë e korporatës.

   ii. Grupi shumëpalësh duhet të bjerë dakord me një përkufizim të duhur të termit "pronar përfitues". Përkufizimi duhet të përafrohet me pikën (f) (i) më lartë, të respektojë normat ndërkombëtare dhe ligjet vendase në fuqi, si dhe të përfshijë pragun e zotërimeve. Përkufizimi duhet po ashtu të specifikojë detyrimet e personave të ekspozuar politikisht.

   iii. Sipërmarrjeve të listuara publikisht, përfshirë filialet në pronësi të plotë, iu kërkohet të deklarojnë emrin e bursës dhe lidhjen me regjistrimet në bursën, në rastet kur ato listohen për të lehtësuar aksesin e publikut në informacionin e tyre mbi pronësinë përfituese.

   iv. Në rastin e sipërmarrjeve të përbashkëta, secila njësi ekonomike brenda sipërmarrjes duhet të deklarojë pronarin(ët) e saj përfitues, përveç nëse është e shënuar publikisht ose është një filial në pronësi të plotë të një shoqërie të listuar publikisht. Çdo entitet është përgjegjës për saktësinë e informacionit të dhënë.

g) Vendet zbatuese dhe grupet shumë-palëshe, duhet gjithashtu të deklarojnë pronarët e ligjshëm dhe pronësinë e aksioneve.

2.6 Përfshirja e shtetit.

a) Kur pjesëmarrja e shtetit në industritë nxjerrëse krijon pagesa të ardhurash materiale, vendet zbatuese duhet të mundësojnë:

   i. Një shpjegim të rolit të ndërmarrjeve shtetërore (NSH) në sektor dhe rregullat dhe praktikat mbizotëruese në lidhje me marrëdhëniet financiare midis qeverisë dhe NSH-ve, d.m.th. rregullat dhe praktikat që rregullojnë transferimet e fondeve midis NSH-ve dhe shtetit, fitimet e mbajtura, ri-investimet dhe financimet e palëve të treta. Kjo duhet të përfshijë bërjen publike të transferimeve, fitimet e mbajtura, ri-investimin dhe financimin e palëve të treta në lidhje me sipërmarrjet e përbashkëta të NSH-ve dhe filialet e tyre.

3. Kërkesat për vendin zbatues të EITI Vazhdon

KËRKESA 2.6 a) i. Vazhdon

Për qëllimet e zbatimit të Standardit EITI, një ndërmarrje në pronësi të shtetit (NSH) është një sipërmarrje e zotëruar tërësisht ose në pjesën më të madhe nga qeveria, e angazhuar
në aktivitetet nxjerrëse në emër të qeverisë. Bazuar në sa më sipër, grupi shumë-palësh inkurajohet të diskutojë dhe dokumentojë përkufizimin e tij për NSH-të, duke marrë parasysh ligjet kombëtare dhe strukturat qeveritare.

ii. Bërja publike nga qeveria dhe NSH-të e nivelit të tyre të pronësisë në miniera, shoqëritë e naftës dhe gazit që veprojnë brenda sektorit të naftës, gazit dhe minierave në vend, përfshirë ato të mbajtura nga filialet e NSH-ve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta, dhe çdo ndryshim në nivelin e pronësisë gjatë periudhës raportuese.

Ky informacion duhet të përmbajë të dhëna që lidhen me kushtet përkatëse për pjesën e tyre të kapitalit, përfshirë nivelin e tyre të përgjegjësisë për mbulimin e
shpenzimeve në faza të ndryshme të ciklit të projektit, p.sh. kapital i paguar plotësisht, kapital i lirë ose interes i mbartur. Aty ku ka pasur ndryshime në nivelin
e pronësisë së qeverisë dhe NSH-ve gjatë periudhës së raportimit EITI, qeveria dhe NSH-të pritet të publikojnë kushtet e transaksioneve, përfshirë detajet në lidhje me vlerësimin dhe të ardhurat. Kur qeveria dhe NSH-të kanë ofruar hua ose garanci kredish për minierat dhe shoqëritë e naftës dhe gazit që operojnë brenda vendit, detajet e këtyre transaksioneve duhet të deklarohen, përfshirë kushtet dhe afatet e kredive (d.m.th. planet e shlyerjeve dhe norma e interesit). Grupet shumëpalëshe mund të dëshirojnë të krahasojnë kushtet e kredive me kushtet e kredive tregtare.

b) NSH-të pritet të bëjnë publike pasqyrat e tyre financiare të audituara, ose zërat kryesorë (d.m.th. bilancin e gjendjes, pasqyra e fitimeve/humbjeve, flukset monetare), në rastet kur pasqyrat financiare nuk janë të disponueshme.

c) Vendet zbatuese inkurajohen të përshkruajnë rregullat dhe praktikat në lidhje me funksionimin dhe shpenzimet kapitale të NSH-ve, prokurimin, nën-kontraktimin dhe qeverisjen e korporatave, p.sh. përbërja dhe emërimi i Bordit të Drejtorëve, mandati dhe kodi i sjelljes së Bordit.

KËRKESA 3

Zbulimi dhe prodhimi.

PËRMBLEDHJE: EITI kërkon publikimin e informacionit në lidhje me kërkimin dhe prodhimin, duke u mundësuar palëve të interesit të kuptojnë potencialin e sektorit. Kërkesat EITI në lidhje me një transparencë në aktivitetet e kërkimit dhe prodhimit përfshijnë: (3.1) informacion në lidhje me aktivitetet e kërkimit; (3.2) të dhënat e prodhimit; dhe (3.3) të dhënat

3.1 Zbulimi.

Vendet zbatuese duhet të publikojnë një përmbledhje të industrive nxjerrëse, duke përfshirë çdo aktivitet të rëndësishëm të kërkimit.

3.2 Prodhimi.

Vendet zbatuese duhet të zbulojnë të dhënat e prodhimit në kohë reale, duke përfshirë vëllimet dhe vlerat e prodhimit nga produkti. Këto të dhëna mund të diferencohen më tej sipas rajonit, shoqërisë ose projektit, dhe përfshijnë burimet dhe metodat për llogaritjen e vëllimeve dhe vlerave të prodhimit.

3.3 Eksportet.

Vendet zbatuese duhet të zbulojnë të dhënat e eksportit në kohë reale, duke përfshirë vëllimet dhe vlerat e prodhimit nga produkti Këto të dhëna mund të diferencohen më tej sipas rajonit, shoqërisë ose projektit, dhe përfshijnë burimet dhe metodat për llogaritjen e vëllimeve të eksportit dhe vlerave të prodhimit.

KËRKESA 4

Mbledhja e të ardhurave

PËRMBLEDHJE: Një informacion i pagesave të shoqërive dhe të ardhurave të qeverisë mund të informojë debatin publik për qeverisjen e industrive nxjerrëse. EITI kërkon publikim gjithëpërfshirës të pagesave të shoqërive dhe të ardhurave të qeverisë nga industritë nxjerrëse. Kërkesat EITI në lidhje me mbledhjen e të ardhurave përfshijnë: (4.1) zbulimi gjithëpërfshirës i taksave dhe të ardhurave; (4.2) shitja e aksioneve të shtetit të prodhimit ose të ardhurave të tjera të mbledhura në natyrë; (4.3) dispozitat e infrastrukturës dhe aranzhimet e shkëmbimit sipas marrëveshjeve të kleringut; (4.4) të ardhurat nga transporti; (4.5) transaksionet e Ndërmarrjeve Shtetërore; (4.6) pagesa në nivel lokal; (4.7) nivelin e ndarjes; (4.8) afatet kohore të të dhënave; dhe (4.9) cilësia e të dhënave të publikuara.

4.1 Deklarimi gjithëpërfshirës i të ardhurave dhe tatimeve.

a) EITI kërkon publikimin e të gjitha pagesave materiale nga shoqëritë e naftës, gazit dhe minierave për qeveritë ("pagesat") dhe të gjitha të ardhurat materiale të marra nga qeveritë nga shoqëritë e naftës, gazit dhe minierave ("të ardhurat") me target një audiencë të gjerë në një mënyrë të aksesueshme, gjithëpërfshirëse dhe të kuptueshme nga publiku. Pritshmëria është që vendet zbatuese të publikojnë informacionin e nevojshëm përmes raportimit të rregullt nga ana e qeverisë dhe korporatave nëpërmjet (faqeve zyrtare të internetit, raportet vjetore, etj.), së bashku me Raportet EITI të përdorura për të mbledhur këtë informacion dhe për të adresuar çdo shqetësim në lidhje me mangësitë dhe cilësinë e të dhënave.

b) Grupit shumëpalësh u kërkohet të bien dakord se cilat pagesa dhe të ardhura janë materiale dhe për këtë arsye duhet të publikohen, përfshirë këtu përkufizimet dhe pragun e vendosur të materiales. Pagesat dhe të ardhurat konsiderohen materiale nëse mosveprimi ose deklarimi i gabuar mund të ndikojë ndjeshëm në gjithëpërfshirjen e informacioneve shpjeguese. Një përshkrim i secilit kanal të të ardhurave, përkufizimet e lidhura me materialen dhe kufijtë duhet të publikohet. Gjatë vendosjes së përkufizimeve dhe pragjeve të materiales, grupi shumëpalësh duhet të marrë parasysh madhësinë e kanaleve të të ardhurave në raport me të ardhurat totale. Grupet shumëpalëshe duhet të dokumentojnë opsionet e konsideruara dhe arsyetimin për vendosjen e përkufizimeve dhe pragjeve.

c) Duhet të përfshihen kanalet e të ardhurave si më poshtë:

   i. E drejta që gëzojnë mbi prodhimin qeveritë vendase (të tilla si fitimet mbi naftën)

   ii. E drejta që gëzojnë mbi prodhimin kombëtar ndërmarrjet shtetërore

   iii. Tatimi mbi fitimet

   iv. Honorarët

   v. Dividendët

   vi. Bonuset si, bonuset e nënshkrimit, zbulimit dhe prodhimit;

   vii. Tarifat e licencave, tarifat e qirasë, tarifat e hyrjes dhe pagesa të tjera për licenca dhe/ose koncesione

KËRKESA 4.1 c) Vazhdon

viii. Çdo pagesa tjetër e rëndësishme dhe përfitim material për qeverinë

Çdo kanal i të ardhurave ose përfitime duhet të përjashtohen vetëm kur ato nuk janë të zbatueshme ose kur grupi shumëpalësh bie dakord që mosveprimi nuk do të ndikojë materialisht në gjithëpërfshirjen e qeverisë dhe deklarimet e publikuara të shoqërive.

d) Vendet zbatuese duhet të sigurojnë që të gjitha entitetet qeveritare që përfitojnë të ardhura materiale nga shoqëritë e naftës, gazit dhe minierave u kërkohet të publikojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse këto të ardhura në përputhje me qëllimin e rënë dakord. Subjektet qeveritare duhet të përjashtohen nga publikimi i të dhënave vetëm nëse mund të demonstrohet se të ardhurat e tyre nuk janë materiale. Në qoftë se nuk ka pengesa të rëndësishme praktike, qeverisë gjithashtu i kërkohet të sigurojë informacione të përgjithshme në lidhje me shumën e të ardhurave totale të përfituara nga secila prej kanaleve të përfitimeve të rëna dakord në fushën e zbatimit të standardit EITI, përfshirë të ardhurat që janë nën pragjet e rëna dakord të materiales. Kur këto të dhëna nuk janë të disponueshme, Administratori i Pavarur duhet të shfrytëzojë të dhëna dhe vlerësime përkatëse nga burime të tjera në mënyrë që të sigurojë një raport kontabiliteti gjithëpërfshirës të të ardhurave totale të qeverisë.

Të gjitha shoqëritë e naftës, gazit dhe minierave që kryejnë pagesa materiale për qeverinë u kërkohet të publikojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse këto pagesa në përputhje me fushën e rënë dakord. Një shoqëri duhet të përjashtohet nga publikimi i të dhënave vetëm nëse mund të demonstrohet që pagesat e saj nuk janë materiale.

e) Shoqëritë pritet të bëjnë transparente publikisht pasqyrat e tyre financiare të audituara, ose zërat kryesorë (d.m.th. bilanci i gjendjes, pasqyra e fitimit/humbjes, flukset e parave) ku pasqyrat financiare nuk janë të disponueshme.

4.2 Shitja e aksioneve të shtetit për prodhimin ose të ardhurat e mbledhura në natyrë

a) Në rastet kur shitja e aksioneve të shtetit të prodhimit të naftës, gazit dhe/ose burimeve minerare ose të ardhura të tjera të mbledhura në natyrë të cilat rezultojnë të jenë materiale, qeveria, duke përfshirë ndërmarrjet shtetërore, kërkohet të publikojë vëllimet e marra dhe të shitura nga shteti (ose palët e treta të kontraktuara nga shteti për të shitur në emër të tij), të ardhurat e marra nga shitja dhe të ardhurat e transferuara në shtet nga të ardhurat e naftës, gazit dhe minerareve të shitura. Kur është e zbatueshme, kjo duhet të përfshijë pagesa (në të holla ose në natyrë) në lidhje me marrëveshjet e shkëmbimit *swap* dhe kreditë me kolateral nga burimet.

Të dhënat e publikuara duhet të ndahen nga shoqëria individuale e blerjes dhe në nivele në përpjesëtim me raportimin e pagesave të tjera dhe kanalet e të ardhurave (4.7). Grupet shumëpalëshe, në konsultim me shoqëritë blerëse, pritet të marrin në konsideratë nëse publikimet duhet të ndahen sipas shitjes individuale, llojit të produktit dhe çmimit.

Publikimet mund të përfshijnë zotërimin e produktit të shitur dhe natyrën e kontratës (p.sh. Pika e shitjes ose afati).

KËRKESA 4.2 Vazhdon

b) Vendet zbatuese përfshirë ndërmarrjet shtetërore inkurajohen të publikojnë një përshkrim të procesit për zgjedhjen e shoqërive blerëse, kriteret teknike dhe financiare të përdorura për të bërë zgjedhjen, listën e shoqërive të përzgjedhura blerëse, çdo devijim material nga kuadri ligjor dhe rregullatore në fuqi që rregullojnë përzgjedhjen e shoqërive blerëse dhe marrëveshjet përkatëse të shitjes.

c) Shoqëritë që blejnë naftë, gaz dhe/ose burime minerare nga shteti, duke përfshirë ndërmarrjet shtetërore (ose palët e treta të caktuara nga shteti për të shitur në emër të tij), inkurajohen të publikojnë vëllimet e marra nga shteti ose ndërmarrje shtetërore dhe pagesa të bëra për blerjen e naftës, gazit dhe/ose burimeve minerare. Publikimi mund të përfshijë pagesa (në të holla ose në natyrë) në lidhje me marrëveshjet e shkëmbimit swap dhe kreditë me kolateral nga burimet.

   Të dhënat e publikuara mund të ndahen nga shitësi individual, kontrata ose shitja.

   Publikimet mund të përfshijnë informacion për natyrën e kontratës (p.sh. pika e shitjes ose afati) dhe portin e ngarkimit.

d) Kur ka shqetësime në lidhje me besueshmërinë e të dhënave dhe kur është praktikisht e realizueshme, grupi shumëpalësh duhet të konsiderojë përpjekjet e mëtejshme për të adresuar çdo boshllëk, mospërputhje dhe parregullsi në informacionin e zbuluar.

4.3 Dispozitat e Infrastrukturës dhe Marrëveshjet e Kleringut

Grupit shumëpalësh u kërkohet të marrin në konsideratë nëse ka ndonjë marrëveshje, ose disa marrëveshje që përfshijnë sigurimin e mallrave dhe shërbimeve (përfshirë kreditë, grantet dhe punët e infrastrukturës), në shkëmbim të plotë ose të pjesshëm të kërkimit ose prodhimit të naftës, gazit ose minierave, koncesione ose shpërndarje fizike të mallrave të tillë. Për të realizuar sa më sipër, grupi shumë-palësh duhet të kuptojë plotësisht: kushtet e marrëveshjeve dhe kontratave përkatëse, palët e përfshira, burimet të cilat janë barrësuar nga shteti, vlera e fluksit të përfitimit balancues (p.sh. punime në infrastrukturë) dhe materialiteti i këtyre marrëveshjeve në lidhje me kontratat konvencionale.

Kur grupi shumë-palësh arrin në përfundimin se këto marrëveshje janë materiale, atij i kërkohet të sigurojë që zbatimi i EITI të adresojë këto marrëveshje dhe, informacionet shpjeguese, të ofrojnë një nivel të dhënash dhe ndarjesh në përpjesëtim me flukset e tjera të pagesave dhe të ardhurave. Grupit shumë-palësh i kërkohet të miratojë një procedurë për të adresuar cilësinë e të dhënave dhe sigurimin e informacionit të parashtruar më lart, në përputhje me parashikimet e Kërkesës 4.9.

4.4 Të ardhurat nga transportet.

Kur të ardhurat nga transporti i naftës, gazit dhe mineraleve janë materiale, qeveria dhe ndërmarrjet shtetërore (NSH-të), pritet të bëjnë publike të ardhurat e marra. Të dhënat e publikuara duhet të paraqesin një nivel

KËRKESA 4.4 Vazhdon

të dhënash dhe ndarjesh në proporcion me pagesat e tjera dhe linjat e të ardhurave (4.7). Grupi shumëpalësh inkurajohet të miratojë një procedurë për të adresuar cilësinë e të dhënave dhe sigurimin e informacionit mbi të ardhurat nga transportet, në përputhje me parashikimet e Kërkesës 4.9.

Vendet zbatuese mund të bëjnë publike:

i. Aranzhimet e transporteve, përfshirë: produktin; itineraret e transportit; dhe sipërmarrjet përkatëse dhe subjektet qeveritare, përfshirë NSH-të, të përfshira në transport.

ii. Përkufizimet e taksave në fuqi të transportit, tarifave ose pagesave të tjera përkatëse, dhe metodologjitë e përdorura për përllogaritjen e tyre.

iii. Tarifat dhe vëllimin e tarifave të mallrave të transportuara.

iv. Të ardhurat e marra nga entet qeveritare dhe NSH-të dhe që lidhen me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve.

4.5 Transaksionet që lidhen me sipërmarrjet shtetërore (SOEs).

Grupi shumë-palësh duhet të sigurojë që procesi i raportimit të adresojë në mënyrë gjithë-përfshirëse rolin e NSH-ve, përfshirë deklarimet gjithë-përfshirëse dhe të besueshme të pagesave materiale të sipërmarrjeve NSH-ve, transfertat e NSH-ve drejt agjencive qeveritare dhe transfertat e qeverisë drejt NSH-ve.

4.6 Pagesat nën-kombëtare.

Grupi shumë-palësh duhet të përcaktojë nëse pagesat e drejtpërdrejta, brenda qëllimit të flukseve të përfitimeve të dakorduara, nga sipërmarrjet te entitetet nën-këmbëtare të qeverisë, janë materiale. Kur janë materiale, grupi shumëpalësh kërkohet të sigurojë që pagesat e sipërmarrjeve për njësitë nën-kombëtare të qeverisë dhe marrja e këtyre pagesave, të deklarohen. Grupit shumëpalësh i kërkohet të miratojë një procedurë për të adresuar cilësinë e të dhënave dhe sigurimin e informacionit mbi pagesat nën-kombëtare, në përputhje me parashikimet e Kërkesës 4.9.

4.7 Niveli i ndarjes.

Kërkohet që të dhënat EITI të ndahen më vete për secilin projekt individual, sipërmarrje, ent qeveritar dhe fluksi i të ardhurave.

Është bërë një projekt ku janë përcaktuar aktivitete operacionale që rregullohen nga një kontratë e vetme, licencë, qira, koncesion ose marrëveshje e ngjashme ligjore dhe formojnë bazën për detyrimet e pagesës me një qeveri. Gjithsesi, nëse shumë nga këto marrëveshje janë të ndërlidhura në mënyrë thelbësore, grupi shumë-palësh duhet të identifikojë dhe dokumentojë qartë se cilat raste konsiderohen projekt i vetëm.

Marrëveshjet ligjore të ndërlidhura në mënyrë thelbësore janë një grup kontratash, licencash, kontratash të qirasë financiare, koncesionesh apo marrëveshjesh të ngjashme të integruara nga pikëpamja operacionale dhe gjeografike, të cilat kanë në thelb kushte të ngjashme dhe janë të nënshkruara me një qeveri, nga të cilat lindin detyrime pagese. Këto marrëveshje mund të rregullohen nga një kontratë, bashkim shoqërish, marrëveshje për ndarjen e prodhimit ose marrëveshje të tjera ligjore gjithëpërfshirëse.

3. Kërkesat për vendin zbatues të EITI Vazhdon

KËRKESA 4.7 Vazhdon

Kur një pagesë e kryer në kudër të deklarimeve të EITI i atribuohet njësisë ekonomike dhe jo projektit, sipërmarrja mund ta deklarojë pagesën në nivelin e njësisë ekonomike.

4.8 Korrektësia e të dhënave.

a) Vendet zbatuese pritet që çdo vit të publikojnë rregullisht dhe në kohë të gjitha të dhënat që lidhen me standardin EITI dhe planin e dakordësuar të punës (1.5). Grupi shumë-palësh duhet të bie dakord mbi periudhën e kontabilitetit të deklaruar nga EITI.

b) Të dhënat e publikuara nuk duhet të jenë më të vjetra se periudha paraprake raportuese sipas periudhës së plotë raportuese të kontabilitetit, p.sh. informacion që ka të bëjë me vitin financiar 2018 duhet të publikohet jo më vonë se deri më 31 dhjetor 2020.

4.9 Cilësia dhe sigurimi i të dhënave.

a) EITI kërkon bërjen e vlerësimeve për të kuptuar nëse pagesat dhe të ardhurat janë subjekt i një procesi të besueshëm dhe të pavarur auditimi, duke zbatuar standardet ndërkombëtare të auditimit. Pritet që informacionet shpjeguese të qeverive dhe sipërmarrjeve, sipas Kërkesës 4, t'i nënshtrohen një auditimi të besueshëm dhe të pavarur, përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit. Pritet që deklarimet shpjeguese sipas Kërkesës 4, të përfshijnë një shpjegim të procedurave të auditimit dhe sigurimit të cilave iu janë nënshtruar të dhënat, me qasjen e publikut në dokumentacionin mbështetës.

b) Grupit shumë-palësh i kërkohet të bie dakord mbi procedurën për adresimin e cilësisë dhe sigurimit të të dhënave, bazuar në një procedurë standarde të miratuar nga Bordi EITI.3 Grupit shumë-palësh i kërkohet të zbatojë procedurën standarde pa ndonjë devijim material. Në rast se grupi me shumë aktorë dëshiron të shmanget nga procedurat standarde, duhet të kërkohet miratimi paraprak i Bordit. Kërkesa nga grupi shumë-palësh duhet të adresojë: (i) arsyetimin e devijimit nga procedura standarde; (ii) nëse ka deklarime rutinë të të dhënave të kërkuara nga Standardi EITI në hollësi; (iii) nëse të dhënat financiare i nënshtrohen një auditimi të besueshëm dhe të pavarur përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare, dhe (iv) nëse ka ruajtje të mjaftueshme të të dhënave historike.

3 I disponueshëm në faqen e Sekretariatit Ndërkombëtar dhe në faqen e eiti.org.

KËRKESA 5

Alokimi i të ardhurave.

PËRMBLEDHJE: EITI kërkon publikimin e informacionit në lidhje me alokimin e të ardhurave, duke u mundësuar palëve të interesit të përfshirë të kuptojnë se si regjistrohen të ardhurat në buxhetet kombëtare dhe, kur është e zbatueshme, në lidhje me buxhetet në nivel lokal, si dhe të gjurmojë shpenzimet sociale nga shoqëritë e biznesit. Kërkesat EITI në lidhje me alokimin e të ardhurave përfshijnë: (5.1) shpërndarja e të ardhurave; (5.2) transfertat në nivel institucionesh qeverisje

5.1 Shpërndarja e të ardhurave nga industria nxjerrëse

Vendet zbatuese duhet të publikojnë një përshkrim të shpërndarjes së të ardhurave nga industritë nxjerrëse.

a) Vendet zbatuese duhet të tregojnë se cilat nga të ardhurat nga industria nxjerrëse, ose para cash apo ato në natyrë, regjistrohen në buxhetin kombëtar. Kur të ardhurat nuk regjistrohen në buxhetin kombëtar, alokimi i këtyre të ardhurave duhet të shpjegohet, me lidhjet që reflektohen në raportet financiare përkatëse, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, p.sh. fondet sovrane dhe fondet e zhvillimit, institucionet qeveritare në nivel lokal, ndërmarrjet shtetërore dhe subjektet e tjera ekstra-buxhetore.

b) Grupet shumëpalëshe inkurajohen të referojnë në sistemet kombëtare të klasifikimit të të ardhurave dhe standardet ndërkombëtare siç janë Manuali i Statistikave të Financave të Qeverisë sipas FMN-së.

5.2 Transfertat në nivel institucionesh të qeverisjes lokale

a) Kur transfertat midis entiteteve qeveritare në nivel kombëtar dhe nivel lokal kanë të bëjnë me të ardhurat e gjeneruara nga industritë nxjerrëse dhe janë të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi, statuti ose ndonjë mekanizëm tjetër i shpërndarjes së të ardhurave, grupit shumëpalësh i kërkohet të sigurojë që materiali në lidhje me transfertat të publikohet. Vendet zbatuese duhet të zbulojnë formulën e ndarjes së të ardhurave, nëse ka, si dhe çdo mospërputhje midis shumës së transferuar të përllogaritur në përputhje me formulën përkatëse të ndarjes së të ardhurave dhe shumës aktuale që u transferua midis institucioneve qendrore qeveritare dhe çdo institucion tjetër varësie në nivel lokal. Grupi shumëpalësh inkurajohet të miratojë një procedurë për të adresuar cilësinë dhe sigurinë e të dhënave të informacionit mbi transfertat në nivel qeverisje vendore, në përputhje me Kërkesën 4.9. Kur ka pengesa praktike ose në kundërshti me kuadrin ligjor në fuqi të rëndësishme për pjesëmarrjen e njësive të qeverisjes në nivel lokal, grupi shumëpalësh mund të kërkojë zbatim të përshtatur në përputhje me parashikimet e Nenit 1 të procedurave të Bordit të EITI për mbikëqyrjen e zbatimit sipas EITI-t në seksionin 4.

b) Grupi shumëpalësh inkurajohet të sigurojë që çdo transfertë materiale sipas gjykimit ose ad-hoc gjithashtu publikohet dhe miratojnë një procedurë për të adresuar cilësinë e të dhënave dhe sigurimin e informacionit mbi transfertat e tilla, në përputhje me Kërkesën 4.9

3. Kërkesat për vendin zbatues të EITI Vazhdon

KËRKESA 5.2 Vazhdon

c) Grupi shumëpalësh mund të zgjedhë më tej të raportojë se si menaxhohen të ardhurat nga industria nxjerrëse të destinuara për programe specifike ose investime në nivelin qeverisje vendore, dhe disbursimet aktuale.

5.3 Menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimet.

Grupi shumëpalësh inkurajohet të publikojë informacione të mëtejshme mbi menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimet, duke përfshirë:

a) Një përshkrim të të ardhurave nxjerrëse të destinuara për programe specifike ose rajone gjeografike. Kjo duhet të përfshijë një përshkrim të metodave për të siguruar përgjegjshmëri dhe efikasitet në përdorimin e tyre.

b) Një përshkrim i buxhetit të vendit dhe proceset e auditimit dhe lidhjet me informacionin e disponueshëm për publikun mbi buxhetimin, shpenzimet dhe raportet e auditimit.

c) Informacion në kohë reale nga qeveria me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të publikut dhe diskutimeve rreth çështjeve të qëndrueshmërisë së të ardhurave dhe varësisë së burimeve. Kjo mund të përfshijë supozimet që parashikohen për vitet e ardhshme në ciklin buxhetor dhe që kanë të bëjnë me prodhimin e parashikuar, çmimet e mallrave dhe parashikimet e të ardhurave që vijnë nga industritë nxjerrëse dhe përqindjen e të ardhurave të pritshme fiskale në të ardhmen që pritet të gjenerohen nga sektori i industrisë nxjerrëse.

KËRKESA 6

SHPENZIMET SOCIALE DHE EKONOMIKE

PËRMBLEDHJE: EITI inkurajon publikimin e informacionit në lidhje me menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimet, duke ndihmuar palët e interesit të vlerësojnë nëse sektori nxjerrës po rezulton efecient në ndikimet dhe rezultatet e dëshirueshme sociale, ekonomike dhe mjedisore. Kërkesat EITI në lidhje me
Proceset e alokimit të të ardhurave përfshijnë: (6.1) shpenzimet sociale dhe mjedisore nga shoqëritë e biznesit; (6.2) Shpenzimet gjysmë - fiskale të NSH-ve; (6.3) një përmbledhje e kontributit të sektorit të industrive nxjerrëse në

6.1 Shpenzimet sociale dhe mjedisore nga shoqëritë nxjerrëse.

a) Kur shpenzimet materiale sociale nga shoqëritë janë të parashikuara nga ligji ose kontrata me qeverinë që rregullon investimet në industritë nxjerrëse, vendet zbatuese duhet të publikojnë këto transaksione.
Grupit shumëpalësh u kërkohet të miratojë një procedurë për të adresuar cilësinë e të dhënave dhe sigurimin e informacionit mbi shpenzimet sociale dhe mjedisore, në përputhje me parashikimet e Kërkesës 4.9. Kur përfitime të tilla ofrohen në natyrë, kërkohet që vendet zbatuese të zbulojnë natyrën dhe vlerën përkatëse të transaksionit në natyrë. Kur përfituesi i shpenzimeve të parashikuara sociale është një palë e tretë, d.m.th. jo
një agjenci qeveritare, kërkohet që të publikohet emri dhe funksioni i përfituesit.
Kur procesi i pajtueshmërisë nuk është i realizueshëm, vendet duhet të bëjnë publike në mënyrë të njëanshme transaksionet nga ana e shoqërive dhe/ose qeverisë.

b) Kur pagesat materiale nga shoqëritë për qeverinë në lidhje me mjedisin janë të parashikuara nga ligji, rregullorja ose kontrata që rregullon investimet në industrinë nxjerrëse, pagesa të tilla duhet të publikohen.

c) Kur grupi shumëpalësh bie dakord që shpenzimet sociale dhe mjedisore dhe transfertat e kryera sipas gjykimit janë materiale, grupi me shumë aktorë palë interesi inkurajohet të zhvillojë një proces raportimi me qëllim arritjen e transparencës në përpjesëtim me transparencën e pagesave dhe të ardhurave të tjera. Grupit shumëpalësh u kërkohet të miratojë një procedurë për të adresuar cilësinë e të dhënave dhe sigurimin e informacionit të parashtruar më lart, në përputhje me parashikimet e Kërkesës 4.9.

6.2 Shpenzimet e lehtësuara nga barra fiskale

Kur pjesëmarrja e shtetit në industritë nxjerrëse gjeneron pagesa materiale të të ardhurave, vendet zbatuese duhet të marrin masa për transparencë të këtyre pagesave nga Ndërmarrjet shtetërore për shpenzimet e tyre të lehtësuara nga barra fiskale. Grupit shumëpalësh i kërkohet të zhvillojë një proces raportimi me qëllim arritjen e një niveli transparence në përpjesëtim me pagesat e tjera dhe burimet e të ardhurave, dhe duhet të përfshijë filialet e Ndërmarrjeve shtetërore dhe bashkimet e operatorëve.

KËRKESA 6.2 Vazhdon

Shpenzimet e lehtësuara nga barra fiskale përfshijnë marrëveshje përmes së cilave Ndërmarrjet shtetërore ndërmarrin shpenzime publike shoqërore siç janë pagesa për shërbimet sociale, infrastrukturën publike, subvencionet e karburanteve dhe shërbimin e borxhit kombëtar, etj. Jashtë skemës së buxhetit kombëtar. Vendet zbatuese dhe grupet shumëpalëshe mund të dëshirojnë të marrin parasysh përkufizimin e FMN-së për shpenzimet e lehtësuara nga barra fiskale kur merret parasysh nëse shpenzimet konsiderohen si të lehtësuara nga barra fiskale.

6.3 Kontributi i sektorit të industrisë nxjerrëse në ekonomi

Vendet zbatuese duhet të bëjnë transparente, kur është e mundur, informacionin në lidhje me kontributin e industrive nxjerrëse në ekonomi për vitin fiskal të mbuluar nga zbatimi i standardeve të EITI. Kërkohet që ky informacion të përmbajë:

a) Madhësia e industrive nxjerrëse në terma absolutë dhe si përqindje e PBB-së, si dhe një vlerësim i aktivitetit të sektorit informal, përfshirë por jo domosdoshmërish të kufizuar në miniera dhe përpunim artizanal në shkallë të vogël.

b) Të ardhurat totale të qeverisë të gjeneruara nga industritë nxjerrëse (përfshirë taksat, honorarët, shpërblimet, tarifat dhe pagesa të tjera) në terma absolutë dhe si përqindje e të ardhurave totale të qeverisë.

c) Eksportet nga industritë nxjerrëse në terma absolutë dhe si përqindje e eksporteve totale.

d) Punësimi në industritë nxjerrëse në terma absolutë dhe si përqindje e punësimit total. Informacioni duhet të jetë të ndara sipas gjinisë dhe, kur është në dispozicion, të ndahen më tej sipas nivelit të shoqërisë së biznesit dhe nivelit të profesionit.

e) Rajonet/zonat kryesore ku prodhimi është i përqendruar.

6.4 Ndikimi i aktiviteteve nxjerrëse në mjedis

Vendet zbatuese inkurajohen të bëjnë informacionin transparent mbi menaxhimin dhe monitorimin e ndikimit mjedisor të industrive nxjerrëse. Informacioni mund të përfshijë:

a) Një përmbledhje të dispozitave ligjore dhe rregullave administrative përkatëse, si dhe praktikat aktuale në lidhje me menaxhimin e mjedisit dhe monitorimin e investimeve të industrive nxjerrëse në vend. Kjo mund të përfshijë informacione mbi vlerësimet e ndikimit në mjedis, skemat e certifikimit, licencat dhe të drejtat e atribuara shoqërive të naftës, gazit dhe minierave, si dhe informacione mbi rolet dhe përgjegjësitë e agjencive përkatëse qeveritare në zbatimin e këtyre rregullave dhe rregulloreve. Mund të përfshijë më tej informacion mbi çdo reformë që është planifikuar ose që mund të jetë në proces.

b) Informacion mbi procedurat e rregullta të monitorimit të mjedisit, proceset administrative dhe sanksionuese të qeverive, si dhe detyrimet mjedisore, programet e rehabilitimit dhe rikuperimit të mjedisit.

KËRKESA 7

Rezultatet dhe ndikimi

PËRMBLEDHJE: Publikimi i rregullt i të dhënave të industrisë nxjerrëse nuk merr rëndësinë e duhur pa rritur ndërgjegjësimin publik paralelisht, duke bërë transparente se çfarë nënkuptojnë shifrat,
dhe organizimin e debatit publik rreth të dhënave se si të ardhurat nga burimet mund të përdoren në mënyrë sa më efektive. Kërkesat EITI në lidhje me rezultatet dhe ndikimin kërkojnë të sigurojnë që palët e interesit të angazhohen në një dialog në lidhje me menaxhimin e të ardhurave të burimeve natyrore. Procesi i transparencës sipas standardeve të EITI bazohen në përmbushjen e Parimeve të EITI duke kontribuar në një debat sa më të gjerë publik. Është gjithashtu me rëndësi thelbësore që të veprohet sipas mësimeve të nxjerra gjatë zbatimit, që rekomandimet nga zbatimet e standardeve të EITI të konsiderohen dhe të zbatohen kur është e përshtatshme dhe që zbatimi i standardeve të EITI të jetë në baza të qëndrueshme dhe solide.

7.1 Debati Publik.

Grupi shumëpalësh duhet të sigurojë që qeveria dhe shoqëria të japin informacione të kuptueshme, të promovuara në mënyrë aktive, të aksesueshme nga publiku dhe të kontribuojnë në debatin publik. Audiencat kryesore duhet të përfshijnë qeverinë, parlamentarët, shoqërinë civile, shoqëritë e biznesit dhe kanalet e medias.

a) Grupi shumëpalësh kërkohet që:

   i. Të sigurojë që informacioni është gjerësisht i aksesueshëm dhe i shpërndarë. Grupi shumëpalësh inkurajohet ta zbërthejë këtë në raporte tematike dhe ta vendosë në dispozicion të publikut në internet.

   ii. Të sigurojë që informacioni është i kuptueshëm, duke përfshirë edhe sigurimin që të jetë shkruar në një stil të qartë, të aksesueshëm dhe në gjuhë të përshtatshme duke konsideruar sfidat e qasjes dhe nevojat për informacion të gjinive dhe nëngrupeve të ndryshme të qytetarëve.

   iii. Të sigurojë që ngjarjet në terren, qofshin ato të organizuara nga qeveria, shoqëria civile ose shoqëritë e biznesit, të organizohen me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe lehtësimin e dialogun për qeverisjen e burimeve të industrisë nxjerrëse, duke u bazuar në publikimin e informacionit sipas standardet e EITI në të gjithë vendin në një mënyrë gjithëpërfshirëse në nivel shoqërie.

b) Grupi shumëpalësh inkurajohet që:

   i. Të prodhojë raporte të shkurtra përmbledhëse, me një analizë të qartë dhe të ekuilibruar të informacionit, duke siguruar që burimet e të dhënave dhe autorësia të shprehen qartësisht.

   ii. Të përmbledhë dhe krahasojë pjesën e secilit kanal të të ardhurave me shumën totale të të ardhurave që i takon çdo niveli përkatës të institucioneve qeveritare.

   iii. Të ndërmarrë iniciativa për ndërtimin e kapaciteteve, veçanërisht me shoqërinë civile dhe përmes organizatave të shoqërisë civile, për të përmirësuar kuptimin e informacionit dhe të dhënave nga raportet dhe publikimet në internet dhe për të inkurajuar përdorimin e informacionit nga qytetarët, nga ana e medias dhe aktorëve të tjerë.

KËRKESA 7 Vazhdon

7.2 Aksesueshmëria dhe të dhënat e hapura

Vendet zbatuese duhet të sigurojnë që publikimi i informacionit sipas standardeve të EITI të bëhen i aksesueshëm për publikun. Grupi shumëpalësh duhet të:

a) Miratimi për një politikë të qartë të të dhënave transparente të hapura për aksesin, publikimin dhe ri-përdorimin e të dhënave sipas standardeve të EITI. Agjencitë qeveritare dhe shoqëritë pritet të publikojnë të dhënat sipas standardeve të EITI nën një licencë të hapur dhe t'i bëjnë përdoruesit të vetëdijshëm se informacioni mund të ripërdoret pa miratimin paraprak.

b) Publikimi të dhënave të disponueshme në një format të hapur të dhënash në internet dhe deklarimi i disponueshmërisë së tyre. Formati i të dhënave të hapura nënkupton që të dhënat mund të bëhen të aksesueshme në formatin CSV ose Excel dhe mund të përmbajnë të gjitha tabelat, grafikët dhe figurat nga Raportet e EITI.

c) Dosjet e plota të të dhënave përmbledhëse për secilin vit fiskal të menaxhuara nga EITI në përputhje me modelin e miratuar nga Bordi i EITI.

d) Grupi shumëpalësh inkurajohet të japë informacione sistematike që mund të lexohen nga pajisje të ndryshme dhe të jenë të ndërveprueshme, dhe të kodojë ose etiketojë procesin e transparencës sipas standardeve të EITI dhe skedarët e tjerë të të dhënave në mënyrë që informacioni të krahasohet me të dhënat e tjera në dispozicion të publikut.

7.3 Rekomandimet nga zbatimi i EITI.

Me qëllim forcimin e ndikimit të zbatimit të EITI në qeverisjen e burimeve natyrore, grupit shumëpalësh u kërkohet të ndërmarrin hapa për të vepruar sipas mësimeve të nxjerra; të identifikojë, hetojë dhe trajtojë shkaqet e çdo mangësie dhe mospërputhje informacioni; dhe të marrin në konsideratë rekomandimet që rezultojnë nga zbatimi i EITI. Grupi shumëpalësh mund të marrë në konsideratë rekomandimet për të rënë dakord për forcimin e sistemeve qeveritare dhe qeverisjen e burimeve natyrore. Kur është e përshtatshme, vendet zbatuese inkurajohen të zbatojnë rekomandimet e tilla.

7.4 Rishikimi i rezultateve dhe ndikimi i zbatimit të standardeve të EITI.

Grupit shumëpalësh i kërkohet të rishikojë rezultatet dhe ndikimin e zbatimit të EITI në qeverisjen e burimeve natyrore.

a) Grupit shumëpalësh i kërkohet të dokumentojnë rishikimin e tyre vjetor të ndikimit dhe rezultateve të zbatimit të EITI në një progres raport vjetor ose përmes mjeteve të tjera të rëna dakord nga grupi shumëpalësh. Kjo duhet të përfshijë çdo veprim të ndërmarrë për të trajtuar çështje që grupi shumëpalësh ka identifikuar si përparësi për zbatimin e EITI. 4 Rishikimi vjetor i ndikimit dhe rezultateve duhet të përfshijë:

   i. Një përmbledhje e aktiviteteve të EITI të ndërmarra gjatë vitit paraprak dhe një përmbledhje e rezultateve të këtyre aktiviteteve.

4 Një model standard është i disponueshëm nga Sekretariati Ndërkombëtar.

3. Kërkesat për vendin zbatues të EITI Vazhdon

KËRKESA 7.4 a) Vazhdon

ii. Një vlerësim i progresit drejt përmbushjes së secilës Kërkesë të EITI, dhe çdo hap të ndërmarrë për të tejkaluar kërkesat. Kjo duhet të përfshijë çdo veprim të ndërmarrë për të trajtuar çështje që grupi shumëpalësh ka identifikuar si përparësi për zbatimin e EITI.

iii. Një përmbledhje e përgjigjeve të grupit shumëpalësh dhe progresi i bërë në trajtimin e rekomandimeve nga rakordimi dhe vlerësimi në përputhje me kërkesën 7.3. Grupit shumëpalësh i kërkohet të rendisë secilin rekomandim dhe aktivitetet përkatëse që janë ndërmarrë për të trajtuar rekomandimet dhe nivelin e progresit në zbatimin e secilit rekomandim. Kur qeveria ose grupi shumëpalësh ka vendosur të mos zbatojë një rekomandim, kërkohet që grupi me shumë palë interesi të dokumentojë arsyetimin.

iv. Një vlerësim i ecurisë drejt përmbushjes së objektivave të përcaktuara në këtë plan pune (Kërkesa 1.5), dhe gjithçka tjetër për ndikimin dhe rezultatet e objektivave të parashikuar.

v. Një përshkrim narrativ i përpjekjeve për të përforcuar ndikimin e zbatimit të standardeve të EITI në menaxhimin e burimeve natyrore, përfshirë çdo veprim për të integruar detajet dhe fushën e raportimit sipas standardeve të EITI ose për të rritur angazhimin me palët e interesit.

Për më tepër, grupi shumëpalësh inkurajohet të dokumentojë mënyrën se si ka marrë në konsideratë gjithëpërfshirjen dhe përfshirjen gjinore.

b) Të gjithë palët e interesit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në rishikimin e ndikimit të zbatimit të standardeve të EITI. Grupet e shoqërisë civile dhe industria e përfshirë në kuadër të EITI, në veçanti, por jo vetëm, ato që i shërbejnë grupit shumëpalësh,
duhet të jenë në gjendje të japin reagime mbi procesin e transparencës sipas standardeve të EITI dhe të kenë të reflektuara pikëvështrimet e tyre në rishikimin vjetor të ndikimit dhe rezultateve.

4. Mbikëqyrja nga Bordi i EITI për zbatimin e standardeve të EITI

Ky seksion përshkruan procedurat dhe kriteret që Bordi i EITI përdor në mbikëqyrjen dhe vërtetimin e zbatimit të standardeve të EITI. Kjo përfshin afatet kohore të vendosura nga Bordi i EITI për publikimin e të dhënave sipas standardeve të EITI dhe mbikëqyrjen e procesit të Validimit.

Neni 1 - Zbatimi i Përshtatur

Nëse grupi shumëpalësh do të dalë në përfundimin se përballet me rrethana të jashtëzakonshme që kërkojnë devijim nga kërkesat e zbatimit, ai duhet të kërkojë miratimin paraprak të Bordit EITI për të pasur një zbatim sa më të përshtatur. Kërkesa duhet të miratohet nga grupi shumëpalësh dhe të pasqyrohet në planin e punës. Kërkesa duhet të shpjegojë arsyetimin e zbatimit të përshtatur.

Bordi i EITI do të konsiderojë përshtatjet e lejuara vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Në shqyrtimin e kërkesave të tilla, Bordi i EITI do të vendosë një përparësi mbi nevojën për zbatim të krahasueshëm midis vendeve duke siguruar që Parimet e EITI të respektohen, duke përfshirë sigurimin që procesi i zbatimit të standardeve të EITI të jetë mjaftueshmërisht gjithëpërfshirës, dhe që publikimet në kuadër të standardeve të EITI të jenë gjithëpërfshirëse, të besueshme dhe të kontribuojnë në debatin publik.

Neni 2 – Afatet e deklarimeve dhe raportimeve

Vendeve zbatuese u kërkohet të publikojnë informacion në kohë reale (Kërkesa 4.8). Vendet zbatuese u kërkohet të publikojnë informacionin e kërkuar (zakonisht përmes një Raporti sipas standardeve të EITI) brenda 18 muajve nga pranimi si një vend i EITI. Pas kësaj, të dhënat e publikuara nuk duhet të jenë më të vjetra se periudha paraprake raportuese sipas periudhës së plotë raportuese të kontabilitetit, p.sh. informacion që ka të bëjë me vitin financiar
që mbyllet më 31 dhjetor 2018 dhe raportimi duhet të publikohet jo më vonë se deri më 31 dhjetor 2020.

Nëse të dhënat nuk publikohen brenda afatit të kërkuar, anëtarësimi i vendit do të pezullohet. Masa e pezullimit hiqet nëse Bordi i EITI është i kënaqur që të dhënat e prapambetura të publikohen brenda gjashtë muajve nga afati i fundit i vendosur. Nëse të dhënat e prapambetura nuk publikohen brenda gjashtë muajve nga afati, pezullimi do të mbetet në fuqi derisa Bordi i EITI të bindet se vendi ka publikuar të dhënat sipas standardeve të EITI në përputhje me parashikimet e Kërkesës 4.8. Nëse pezullimi është në fuqi për më shumë se një vit, Bordi i EITI do të heqë nga lista vendin anëtar.

Neni 3 – Afati fillestar i Validimit.

Kur Bordi i EITI pranon vendet zbatuese, do të përcakton një afat përfundimtar për fillimin e Validimit brenda një periudhe prej dy vjetësh e gjysmë. Pas shqyrtimit të gjetjeve, Bordi do të përcaktojë një afat përfundimtar për Validim të Mëtejshëm (Neni 5).

Neni 4 – Procesi i Validimit nga EITI

a) Vlerësimi i çdo kërkese të EITI

Procesi i Validimit do të vlerësojë progresin e vendit në përputhje me përmbushjen e secilës nga kërkesat e EITI. Udhëzime të hollësishme për llojet e provave që kërkohen për të kryer një vlerësim të kërkesave individuale përcaktohet në Udhëzuesin e Validimit. Niveli i progresit dhe pajtueshmërisë me secilën Kërkesë individuale të EITI do të tregohet duke zbatuar një nga përcaktimet e mëposhtme:

Progres i jashtëzakonshëm. Në mënyrë që Bordi i EITI të konkludojë se një vend ka bërë përparim të jashtëzakonshëm, Validimi duhet të dëshmojë se të gjitha aspektet e kërkesës, përfshirë aspektet 'e pritshme', 'të inkurajuara' dhe 'të rekomanduara', janë zbatuar dhe se objektivi më i gjerë i kërkesës është përmbushur përmes publikimeve sistematike në sistemet e institucioneve qeveritare dhe sistemet e shoqërive të biznesit.

Progres i kënaqshëm. Në mënyrë që Bordi i EITI të konkludojë se një vend ka bërë përparim të kënaqshëm, Validimi duhet të dëshmojë se të gjitha aspektet e kërkesës janë zbatuar dhe se objektivi më i gjerë i kërkesës është përmbushur.

Progres i konsiderueshëm. Në mënyrë që Bordi i EITI të konkludojë se një vend ka bërë përparim të konsiderueshëm, Validimi duhet të dëshmojë se të gjitha aspektet substanciale të kërkesës janë zbatuar dhe se objektivi më i gjerë i kërkesës është përmbushur.

Progres i pamjaftueshëm Në mënyrë që Bordi i EITI të konkludojë se një vend ka bërë përparim të pamjaftueshëm, Validimi duhet të dëshmojë se të gjitha aspektet substanciale të kërkesës nuk janë zbatuar dhe se objektivi më i gjerë i kërkesës nuk është përmbushur.

Mungesë progresi. Në mënyrë që Bordi i EITI të konkludojë se një vend ka mungesë progresi, Validimi duhet të dëshmojë se të gjitha ose asnjë nga aspektet e kërkesës nuk janë zbatuar dhe se objektivi më i gjerë i kërkesës nuk është përmbushur.

b) Vlerësimi i përgjithshëm

Bordi i EITI do të kryejë një vlerësim të pajtueshmërisë së përgjithshme me të gjitha kërkesat e parashikuara në Standardin EITI. Në përcaktimin e vlerësimit të përgjithshëm të një vendi, Bordi i EITI do të zbatojë të njëjtën shkallë siç përdoret për vlerësimin e kërkesave individuale të përshkruara në Nenin 4 (a) më sipër. Bordi do të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Rezultatet e vlerësimit të kërkesave individuale dhe nëse këto rezultate të marra së bashku tregojnë qartësisht për një vlerësim të përgjithshëm të 'progresit të kënaqshëm', 'progresit të konsiderueshëm', 'progres i pamjaftueshëm' ose 'mungesë progresi';
- Këshillat dhe rekomandimet e Validuesve dhe Komitetit të Validimit;

NENI 4 b) Vazhdim

- Natyra e kërkesave të cilat nuk janë zbatuar dhe sa pranë përmbushjes së kërkesave rezulton vendi;
- Madhësia dhe kompleksiteti i sektorit të industrive nxjerrëse të vendit;
- Pengesa të tjera për të përmbushur kërkesat, të tilla si, por pa u kufizuar me, brishtësinë e institucioneve shtetërore dhe ndryshimet e fundit ose të vazhdueshme politike, dhe shkallën që grupi shumëpalësh ka ndërmarrë veprime për të zgjidhur pengesat e hasura;
- Përpjekjet në mirëbesim të ndërmarra nga grupi shumëpalësh për të përmbushur kërkesat;
- Arsyet dhe argumentet për mos-përmbushjen e kërkesave; dhe
- Çdo plan i rënë dakord nga grupi shumëpalësh për të trajtuar kërkesat në të ardhmen.

Përveç vlerësimit të kërkesave, Validimi do të dokumentojë:

- **Përpjekjet për të tejkaluar Kërkesat EITI.** Kjo do të përfshijë përpjekjet nga grupi me shumëpalësh për të adresuar 'inkurajuar' ose 'rekomanduar' aspekte sipas Standardit EITI. Përpjekjet gjithashtu përfshijnë angazhimin nga grupi i shumëpalësh për të arritur me sukses çdo objektiv të planit të punës që bien jashtë qëllimit të Standardit të EITI, por që ka janë identifikuar nga grupi i shumëpalësh si objektiva të nevojshëm në kuadër të standardit EITI për të adresuar përparësitë kombëtare për sektorin e industrive nxjerrëse.
  Këto përpjekje do të dokumentohen në procesin e Validimit por nuk do të merren parasysh në vlerësimin e përputhshmërisë me Standardin EITI. Kur Validimi arrin në përfundimin se grupi shumëpalësh ka zbatuar në mënyrë gjithëpërfshirëse aspekte të "inkurajuara" ose "të rekomanduara" të Standardit EITI dhe/ose objektivave të planit të punës, Bordi i EITI do t'i njohë këto përpjekje në kartelën e vlerësimit.
- Drejtimi i progresit drejt përmbushjes së secilës Kërkesë të EITI krahasuar me Validimin (-et) e mëparshme të vendit, duke dëshmuar nëse zbatimi po përmirësohet ose po përkeqësohet.

Në përputhje me Standardin Kushtet e Referencës për Validimet, rezultatet e vlerësimit do të dokumentohen në një kartë vlerësimi dhe në një raport narrativ, duke paraqitur provat, pikëpamjet, referencat dhe konkluzionet e palëve të interesit.

Neni 5 - Ndalimet

Nëse një vend ka bërë progres të pamjaftueshëm ose më pak në ndonjë prej kërkesave në lidhje me angazhimin e palëve të interesit (Kërkesat 1.1, 1.2 dhe 1.3), Bordi do të pezullojë vendin në përputhje me Nenin 8.

Nëse, gjatë Validimit të parë, një vend ka bërë progres të konsiderueshëm në përmbushjen e Kërkesës 1.3 për shoqërinë civile për shkak të një mangësie në lidhje me protokollin e shoqërisë civile, vendi nuk do të pezullohet dhe pritet të demonstrojë progres në adresimin e veprimeve korrigjuese të vendosura nga Bordi. Paaftësia për të demonstruar progres në adresimin e veprimeve korrigjuese në Validimet pasuese do të rezultojë në pezullim në përputhje me Nenin 8.

Neni - 6 Vlerësimet e Validimeve

Kur Validimi verifikon që një vend ka bërë progres të kënaqshëm në përmbushjen e të gjitha kërkesave, Bordi i EITI do të përcaktojë për atë vend që ka arritur progres të kënaqshëm në përgjithësi. Vendet zbatuese duhet të jenë të qëndrueshëm në respektimin e Parimeve dhe Kërkesave të EITI në mënyrë që të mbajnë këtë status. Kur ngrihen shqetësime nëse zbatimi i standardit EITI nuk përmbush kriteret e standardit të kërkuar, Bordi i EITI rezervon të drejtën të kërkojë që vendi t'i nënshtrohet një Validimi të ri. Palët e interesit mund të drejtojnë kërkesë për Bordin e EITI
nëse konsiderojnë se statusi duhet të rishikohet. Kjo kërkesë mund të ndërmjetësohet përmes përfaqësuesit (-ve) të vendi anëtar palë interesi në Bordin EITI. Bordi EITI do të rishikojë situatën dhe mbetet në gjykimin e tij nëse do të kërkojë një Validim të parakohshëm.. Në varësi të gjetjeve të këtij vlerësimi, Bordi i EITI do të përcaktojë statusin e vendit.

Pasojat e mos arritjes së progresit të kënaqshëm varen nga vlerësimi i përgjithshëm i Bordit:

i. **Mungesë progresi.** Vendi mund të nxirret nga lista.

ii. **Progres i pamjaftueshëm.** Vendi do të pezullohet përkohësisht dhe do të kërkohet të ndërmarrë veprime korrigjuese deri në kryerjen e procesit të Validimit të dytë. Që pezullimi të hiqet, vendi duhet që në Validimin e tij të dytë të demonstrojë progres të paktën të konsiderueshëm.

   Nëse një vend arrin progres të konsiderueshëm në Validimin e dytë, zbatohet procedura në dispozitën (iii) (2) më poshtë. Nëse vendi arrin
   progresi të pamjaftueshëm, në Validimin e dytë zbatohet procedura e parashikuar në dispozitën (i) më sipër.

iii. **Progres i konsiderueshëm.** Vendi konsiderohet vend zbatues i EITI dhe do të kërkohet të ndërmarrë veprime korrigjuese deri në kryerjen e procesit të Validimit të dytë.

   (1) Nëse vendi arrin progres të konsiderueshëm në përgjithësi në Validimin e dytë, **por pa ndonjë përmirësim në kërkesat individuale,** vendi do të pezullohet përkohësisht dhe do të kërkohet të ndërmarrë veprime korrigjuese deri në Validimin e tretë. Nëse vendi arrin progres të konsiderueshëm në përgjithësi në Validimin e tretë, por pa ndonjë përmirësim të kërkesave individuale, vendi do të hiqet nga lista. Nëse vendi arrin progres të konsiderueshëm në përgjithësi në Validimin e tretë, por me përmirësime të konsiderueshme në disa kërkesa individuale (d.m.th. disa por jo të gjitha kërkesat që më parë nuk ishin përmbushur), vendi do të mbetet me status të pezulluar. Bordi do të përcaktojë masa të reja korrigjuese. Mospërmbushja e të gjitha kërkesave (d.m.th. adresimi i të gjitha veprimeve korrigjuese të prapambetura) në Validimin e katërt do të rezultojë në heqjen nga lista si vend zbatues.

   (2) Nëse vendi arrin progres të konsiderueshëm në përgjithësi në Validimin e dytë, **por me përmirësime të konsiderueshme në disa kërkesa individuale** (d.m.th. disa por jo të gjitha kërkesat që më parë nuk ishin përmbushur), vendi do të konsiderohet një vend zbatues i EITI me kush ndërmarrjen e masave korrigjuese. Nëse vendi arrin progres të konsiderueshëm në përgjithësi në Vlerësimin e tretë, vendi do të pezullohet përkohësisht. Bordi do të vendosë veprime të reja korrigjuese. Mospërmbushja e të gjitha kërkesave (d.m.th. adresimi i të gjitha veprimeve korrigjuese të prapambetura) në Validimin e katërt do të rezultojë në heqjen nga lista si vend zbatues.

Neni 6. iii. VAZHDON

(3) Nëse vendi arrin progres të pamjaftueshëm në Validimet e dyta ose të mëvonshme, zbatohet procedura në paragrafin (i) më sipër.

Kur Validimi verifikon që një vend nuk ka arritur pajtueshmërinë, Bordi i EITI do të përcaktojë veprimet korrigjuese që vendit i kërkohet të ndërmarrë dhe një periudhë kohore prej 3-18 muaj për Validimin e ardhshëm, ku
do të vlerësohet progresi në përmbushjen e veprimeve korrigjuese. Gjatë përcaktimit të periudhës kohore për përcaktimin e veprimeve korrigjuese, Bordi EITI do të marrë parasysh natyrën e veprimeve korrigjuese dhe rrethanat lokale. Bordi rezervon të drejtën për të vendosur afate më të shkurtra ose më të gjata.

Një vend zbatues mund të kërkojë një zgjatje të këtij afati kohor në përputhje me parashikimet e nenit 7. Një vend mund të kërkojë gjithashtu që të fillojë Validimin më herët sesa është planifikuar nga Bordi i EITI.

Një vend zbatues mund të mbajë një nivel të progresit të përgjithshëm që është më pak se i kënaqshëm për një maksimum prej shtatë vjetësh nga data që vendi caktohet si një vend zbatues i EITI.

Neni 7 – Zgjatja e Afatit.

Një vend zbatues mund të kërkojë një zgjatje afati nëse nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë nga afatet e specifikuara më sipër. Bordi i EITI do të zbatojë testimet e mëposhtme për të vlerësuar kërkesat për zgjatje afati:

1. Kërkesa duhet të kryhet para afatit të fundit dhe të miratohet nga grupi shumëpalësh.
2. Grupi shumëpalësh duhet të demonstrojë se ka bërë progres të vazhdueshëm drejt përmbushjes së afatit dhe është vonuar për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme. Në vlerësimin e progresit të vazhdueshëm, Bordi EITI do të konsiderojë:
    i. Procesi EITI, në veçanti funksionimi i grupit shumëpalësh dhe angazhimi i qartë, i fortë nga qeveria.
    ii. Statusi dhe cilësia e raportimit sipas standardeve EITI, duke përfshirë progresin e konsiderueshëm në përmbushjen e kërkesave për raportim në kohë reale, sipas parashikimeve të Kërkesës 4.8 dhe përpjekjet për të adresuar rekomandimet për përmirësimin e raportimit sipas EITI.
3. Rrethanat (et) e jashtëzakonshme duhet të shpjegohen në kërkesën nga grupi shumëpalësh.
4. Nuk do të jepen shtesa afati që do të rrisnin periudhën maksimale të kandidimit.

Neni 8 – Pezullimi

a) Pezullimi për shkak të shkeljes së Parimeve dhe Kërkesave të EITI

Kur është e qartë se një aspekt i rëndësishëm i Parimeve dhe Dispozitave EITI nuk respektohet nga një vend zbatues, Bordi i EITI do ta pezullojë ose heq nga lista atë vend. Kjo përfshin rastet kur një vend
nuk ka përmbushur kërkesat për raportimin në kohë të EITI dhe/ose arritjen e pajtueshmërisë me Kërkesat EITI brenda afateve të përcaktuara nga Bordi i EITI. Kur Bordi EITI ka shqetësimin se Parimi dhe Dispozitat EITI janë kompromentuar, ai mund të ngarkojë Sekretariatin Ndërkombëtar për mbledhje të dhënash në lidhje me situatën dhe dorëzimin e një raporti pranë Bordit të EITI."

Pezullimi i një vendi zbatues është një mekanizëm i përkohshëm dhe i nënshtrohet periudhës maksimale të kandidimit. Bordi EITI vendos një afat kohor për vendin zbatues për të adresuar shkeljet e standardit
EITI Gjatë periudhës së pezullimit, vendi do të ketë statusin "pezulluar". Nëse çështja zgjidhet deri në përmbushjen e kënaqshme brenda afatit sipas vlerësimit nga ana e Bordit EITI , statusi i vendit dhe niveli i progresit do të rivendosen. Nëse çështja nuk është zgjidhur deri në përmbushjen e kënaqshme të plotësimit të kërkesave brenda afatit, atëherë Bordi EITI do të heqë vendin nga lista.

b) Pezullimi për shkak të paqëndrueshmërisë politike ose konfliktit

Bordi EITI mund të vendosë të pezullojë vendet në rastet kur paqëndrueshmëria politike ose konflikti në mënyrë të dukshme e ndalon vendin nga përmbushja e një aspekti të rëndësishëm të Parimeve dhe Kërkesave të EITI. Vendet që përjetojnë paqëndrueshmëri ose konflikt të jashtëzakonshëm politik gjithashtu mund të aplikojnë vullnetarisht për t'u pezulluar. Në këtë situatë, qeveria duhet të paraqesë një kërkesë për pezullim vullnetar pranë Bordit EITI. Në kërkesën e qeverisë për aplikim pezullimi duhet të shënohen pikëpamjet e grupit shumëpalësh.

Kur vendet pezullohen për shkak të paqëndrueshmërisë politike ose konfliktit, periudha që pezullohet vendi nuk do të llogaritet si pjesë e periudhës maksimale të kandidimit. Bordi i EITI do të monitorojë dhe rishikojë situatën rregullisht dhe rezervon të drejtën për të zgjatur periudhën e pezullimit ose për të hequr nga lista vendin në fjalë.

c) Heqja e pezullimit

Qeveria mund të kërkojë që pezullimi të hiqet në çdo kohë. Aplikimi duhet të dokumentojë hapat e miratuara nga palët e interesit për të rifilluar procesin e zbatimit dhe vlerësimit të EITI, dhe planin e punës për të arritur pajtueshmërinë. Nëse Bordi EITI është i kënaqur që arsyet e pezullimit janë adresuar, pezullimi do të hiqet. Me heqjen e një pezullimi,
Bordi EITI do të konsiderojë caktimin e afateve të reja të raportimit dhe Validimit, siç është e përshtatshme. Në të gjitha fazat e procesit, Bordi i EITI do të sigurojë që shqetësimet dhe vendimet e tij t'i komunikohen qartësisht vendit zbatues.

Neni 9 – Heqja nga lista.

Heqja nga lista, d.m.th revokimi i statusit të një vendi si vend zbatues i EITI, do të ndodhë nëse:

(1) Një vend zbatues i është nënshtruar pezullimit dhe çështja nuk është zgjidhur deri në masën e kënaqshme për Bordin EITI brenda afatit të rënë dakord.

(2) Bordi i EITI konkludon se një vend nuk ka bërë progres të kënaqshëm në zbatimin e EITI brenda afateve të përcaktuara kohore.

Kur është e qartë se një aspekt i rëndësishëm i Parimeve dhe Dispozitave EITI nuk respektohet nga një vend zbatues, Bordi EITI do ta pezullojë ose heq nga lista atë vend. Një vend i hequr nga lista mund të riaplikojë për pranim si një vend zbatues i EITI në çdo kohë. Bordi i EITI do të zbatojë procedurat e rëna dakord në lidhje me vlerësimin e kërkesave për aplikim të vendit zbatues EITI. Ai gjithashtu do të vlerësojë përvojën e mëparshme në zbatimin e EITI, duke përfshirë pengesat e mëparshme për zbatimin efektiv dhe zbatimin e masave korrigjuese.

Neni 10 – Apelimet.

Vendi zbatues në fjalë mund të kërkojë nga Bordi i EITI të rishikojë vendimin e tij në lidhje me pezullimin, heqjen nga lista ose përcaktimin e vlerësimit se vendi se ka bërë progres të konsiderueshëm ose të kënaqshëm pas procesit të Validimit. Duke iu përgjigjur kërkesave të tilla, Bordi i EITI do të marrë parasysh faktet e çështjes, nevojën për të ruajtur integritetin e standardeve EITI dhe parimin e respektimit të qëndrueshëm midis vendeve. Vendimi i Bordit EITI është përfundimtar. Vendi në fjalë mund, para periudhave të njoftimit sipas nenit 7 të Statutit të Shoqatës, të apelojë një vendim të Bordit EITI në Takimin e ardhshëm të Anëtarëve.

Rezultatet dhe pasojat e Validimit



5. Përmbledhje e Validimit

Kjo pjesë ka të bëjë me Validimin sipas standardeve të EITI. Qëllimi i Validimit është të vlerësojë përputhshmërinë me Kërkesat EITI të përcaktuara në seksionin 3.

Objektivat e Validimit

Validimi është një tipar thelbësor i procesit të EITI. Shërben për të vlerësuar performancën dhe për të promovuar dialogun dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive në nivel vendi. Procesi i validimit gjithashtu mbron integritetin e EITI duke mbajtur nivelin e përputhshmërisë nga ana e vendeve zbatuese në të njëjtin standard global. Validimi ka për qëllim t'u sigurojë të gjithë palëve të interesit një vlerësim të paanshëm nëse zbatimi i kërkesave EITI në një vend është në përputhje me dispozitat e Standardit EITI. Raporti i Validimit, përveç kësaj, synon të identifikojë ndikimin e EITI në vendin që është në proces validimi, zbatimin e aktiviteteve të inkurajuara nga Standardi EITI, mësimet e nxjerra në zbatimin e EITI, si dhe çdo shqetësim që palët e interesit kanë shprehur dhe rekomandimet për zbatimin në të ardhmen të EITI.

Metodologjia e validimit

Validimi vlerëson progresin drejt përmbushjes së Kërkesave EITI të përcaktuara në seksionin 3. Metodologjia përcaktohet në Udhëzuesin e Validimit, me udhëzime për vlerësimin e secilës dispozitë të Standardit EITI. Në disa raste, Udhëzuesi i Validimit specifikon provat që validuesi duhet të përdorë për të siguruar që një dispozitë është përmbushur. Në raste të tjera, ka qasje të ndryshme që një vend mund të ndërmarrë për të adresuar një dispozitë EITI, dhe Udhëzuesi i Validimit ofron shembuj të llojeve të provave që validuesi mund të marrë në konsideratë.

Procedurat e validimit

Duke pasur parasysh natyrën shumëpalëshe të EITI dhe rëndësinë e dialogut, procedura e Validimit thekson konsultimet me palët e interesit. Validimi kryhet në katër faza.

1. **Përgatitja për Validimin** Para fillimit të Validimit, grupi shumëpalësh inkurajohet të ndërmarrë një vetëvlerësim të përputhshmërisë me Standardin EITI. Udhëzimi i Valdimit përfshin një dispozitë që parashikon se: "Kur grupi shumëpalësh dëshiron që Validimi t'i kushtojë vëmendje të veçantë vlerësimit të disa objektivave ose aktiviteteve në përputhje me planin e punës së grupeve shumëpalëshe, këto duhet të përshkruhen me kërkesë të grupit shumëpalësh". Sekretariatit kombëtar i kërkohet të përpilojë dokumentacionin dhe burime të tjera që demonstrojnë pajtueshmërinë, përfshirë procesverbalet e grupeve shumëpalëshe. Palët e interesit gjithashtu ftohen të përgatisin çdo dokumentacion tjetër që ata e konsiderojnë të rëndësishëm. Një shënim udhëzues për përgatitjen e Vlerësimit është i disponueshëm5.

5 I disponueshëm nga Sekretariati Ndërkombëtar dhe mund ta gjeni në këtë lidhje eiti.org/guide, shënimi i udhëzimit nr 23.

5. Përmbledhje e Validimit Vazhdim

PROCEDURA E VALIDIMIT VAZHDON

2 **Mbledhja fillestare e të dhënave dhe konsultimi me palët e interesit nisma të ndërmarra nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI.** Sekretariati Ndërkombëtar rishikon dokumentacionin përkatës, viziton vendin dhe konsultohet me palët e interesit. Ky proces përfshin takime me grupin shumëpalësh, Administratorin e Pavarur dhe aktorët e tjerë kyç, duke përfshirë palët e interesit që përfaqësohen në grupin me shumëpalësh por jo si pjesëmarrës direkt. Bordi bazon punën në një procedurë të standardizuar për mbledhjen e të dhënave, duke adresuar konsultimet me palët e interesit dhe afatet për përfundimin e validimit fillestar.

Bazuar në këto konsulta, Sekretariati Ndërkombëtar do të përgatisë një raport duke bërë një vlerësim fillestar të progresit në raport me përmbushjen e kërkesave në përputhje me Udhëzuesin e Validimit. Vlerësimi fillestar nuk do të përfshijë një vlerësim të përgjithshëm të pajtueshmërisë.

Raporti i dorëzohet Validuesit. Koordinatori Kombëtar merr një kopje. Komentet mbi faktet mirëpriten, por Koordinatorët Kombëtarë dhe grupi shumëpalësh inkurajohen të rezervojnë çdo koment thelbësor derisa të marrin raportin paraprak të Validatuesit.

3 **Validimi i Pavarur.** Bordi do të emërojë një Validues të Pavarur përmes një procesi tenderimi të hapur dhe konkurrues. Validuesi do t'i raportojë Bordit përmes Komitetit të Validimit.

Validuesi vlerëson nëse vlerësimi fillestar i Sekretariatit është kryer në përputhje me Udhëzuesin e Validimit. Procesi do të përfshijë: një rishikim të detajuar të dokumentacionit përkatës për secilën kërkesë dhe vlerësimin fillestar të Sekretariatit për secilën kërkesë duke konsideruar dhe një qasje të bazuar në rrezik për kontrollet në vend, dhe konsultimet e mëtejshme me palët e interesit. Bordi mund të kërkojë që Validuesi të ndërmarrë kontrolle në vend në lidhje me kërkesat specifike.

Validuesi komenton vlerësimin fillestar të Sekretariatit dhe përgatit një Raport Paraprak të Validimit. Grupi shumëpalësh është i ftuar të komentojë mbi Raportin Paraprak të Validimit. Duke marrë në konsideratë komentet e grupit shumëpalësh, Validuesi përpilon një Raport Përfundimtar të Validimit. Validuesi i shkruan grupit shumëpalësh për të shpjeguar se si i ka konsideruar komentet e tyre. Grupi shumëpalësh merr një kopje të Raportit Përfundimtar të Validimit.

Raporti Përfundimtar i Validimit do të përfshijë vlerësimin e Validuesit të pajtueshmërisë me secilën dispozitë, por jo të gjithë vlerësimin e përgjithshëm të përputhshmërisë. Validuesi ftohet të paraqesë gjetjet në Komitetin e Validimit.

4 **Rishikimi i Bordit.** Komiteti i Validimit do të rishikojë Raportin Përfundimtar të i Validimit dhe dokumentacionin mbështetës (përfshirë komentet e grupit shumëpalësh). Komiteti i Validimit më pas do t'i bëjë një rekomandim Bordit të EITI mbi pajtueshmërinë e vendit me Kërkesat e EITI dhe, kur është e zbatueshme, çdo veprim korrigjues të kërkuar.

PROCEDURA E VALIDIMIT VAZHDON

Bordi i EITI do të kryejë përcaktimin përfundimtar nëse kërkesat janë përmbushur ose të paplotësuara, dhe mbi pajtueshmërinë e përgjithshme të vendit në përputhje me Nenin 6 të procedurave të bordit të EITI për mbikëqyrjen e zbatimit të standardit EITI.

Vlerësimi fillestar, Raporti i Validimit dhe komentet shoqëruese të grupeve të interesit konsiderohen konfidenciale derisa Bordi të marrë një vendim.

6. Protokolli: Pjesëmarrja e shoqërisë civile

1.Hyrje

Pjesëmarrja e shoqërisë civile është thelbësore për arritjen e objektivave të EITI, përfshirë Parimin 4 i cili parashikon se "ndërgjegjësimi i publikut për të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë me kalimin e kohës mund të ndihmojë debatin publik dhe informimin mbi zgjedhjen e opsioneve të përshtatshme dhe realiste për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm". Pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile në procesin e EITI është thelbësore për të siguruar që transparenca e krijuar nga EITI çon në një llogaridhënie më të madhe. Një motiv kryesor për miratimin e Standardit EITI ishte dëshira për të prodhuar një informacion më të rëndësishëm, më të besueshëm dhe më të përdorshëm dhe për ta lidhur më mirë këtë informacion me reformat më të gjera në qeverisjen e sektorit të industrive nxjerrëse ose të menaxhimit të kontabilitetit publik dhe administrimit të të ardhurave. Aftësia e qytetarëve për të punuar në mënyrë aktive për të përdorur informacionin e gjeneruar nga EITI është pra një komponent kritik i zbatimit të standardit të EITI me pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset e transparencës së EITI.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin EITI vlerësohet zyrtarisht në dy faza të zbatimit të standardit të EITI - gjatë vlerësimit të kandidaturave dhe gjatë procesit të Validimit. Një vlerësim i pjesëmarrjes së shoqërisë civile mund të bëhet gjithashtu mbi një bazë *ad hoc* në përgjigje të shqetësimeve specifike të ngritura në Bord në lidhje me situatën në vendet specifike zbatuese. Ky protokoll përcakton pyetjet që Bordi EITI (përfshirë Komitetet) dhe validuesit duhet të marrin në konsideratë për të vlerësuar nëse dispozitat që i përkasin pjesëmarrjes së shoqërisë civile (Kërkesa 1.3) janë përmbushur, si dhe llojet e provave që do të përdoren në adresimin e atyre pyetjeve. Ndërsa dispozitat në lidhje me pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin EITI mbeten të qëndrueshme në çdo fazë të zbatimit të EITI, provat që Bordi EITI përdor për të vlerësuar dispozitat do të ndryshojnë në varësi të rrethanave të vendit, fazës
së zbatimit dhe disponueshmërise së informacionit. Duhet theksuar se pyetjet e shtruara dhe llojet e sugjeruara të provave të paraqitura në 2.1-2.5 më poshtë nuk përbëjnë dispozita, dhe as lista nuk është shteruese. Sidoqoftë, procesi siguron një kornizë vlerësimi për dispozitat që lidhen me shoqërinë civile.

2. Interpretimi i dispozitave të EITI për shoqërinë civile

Për qëllime të këtij protokolli, referenca "përfaqësues të shoqërisë civile" përfshin përfaqësuesit e shoqërisë civile të cilët janë të përfshirë aktivisht në procesin EITI, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, anëtarët e grupeve shumëpalëshe.
Referenca "procesi EITI" përfshin aktivitetet që lidhen me përgatitjet për anëtarësimin pranë EITI; takimet e grupeve shumëpalëshe (MSG); anëtarët e OSHC-ve me të drejtë vote
në lidhje me EITI, përfshirë bashkëveprimet me përfaqësuesit e MSG-ve; prodhimin e Raporteve EITI; prodhimin e materialeve ose kryerjen e analizave për efekt të Raporteve EITI; shprehja e pikëpamjeve në lidhje me aktivitetet e EITI; dhe, shprehja e pikëpamjeve në lidhje me qeverisjen e burimeve natyrore.

Në vlerësimin e dispozitave për shoqërinë civile, Bordi dhe validuesit do të zbatojnë testimet e mëposhtme:

2.1 Liria e shprehjes: Përfaqësuesit e shoqërisë civile mund të përfshihen në debate publike mbi procesin EITI dhe të shprehin mendimet e tyre në lidhje me procesin EITI pa kufizime, të detyruar ose, masa ndëshkimore.

Bordi dhe vlerësuesit e EITI do të marrin në konsideratë shkallën në të cilën:

- Përfaqësuesit e shoqërisë civile mund të shprehen lirshëm në publik mbi procesin EITI, përfshirë, për shembull, gjatë takimeve të MSG-ve, evenimenteve EITI, përfshirë ato për bërjen publike të Raporteve EITI, evenimentet publike, në media etj.
- Praktika aktuale, duke përfshirë pikëpamjet e ndryshme të palëve të interesit ose provat thelbësore të siguruara nga palë të treta të pavarura, tregojnë se auto-censurimi apo kufizimi i vetë-imponuar i përfaqësuesve të shoqërisë civile lidhet me procesin EITI për shkak të frikës nga ndonjë masë ndëshkimore dhe nëse pengesa të tilla kanë ndikuar në shpërndarjen e informacionit nga përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe në komentet publike mbi procesin EITI.

2.2 Veprimi: Përfaqësuesit e shoqërisë civile mund të veprojnë lirshëm në lidhje me procesin EITI.

Bordi dhe vlerësuesit e EITI do të marrin në konsideratë shkallën në të cilën mjedisi ligjor, rregullator, administrativ dhe shoqëror ka ndikuar në aftësinë e përfaqësuesve të shoqërisë civile për të qenë pjesë e procesit EITI. Kjo mund të përfshijë, për shembull:

- Shkallën në të cilën pengesat ligjore, rregullatore ose administrative që ndikojnë në aftësinë e përfaqësuesve të shoqërisë civile për të marrë pjesë në procesin EITI. Kjo mund të përfshijë procedurat ligjore ose administrative për regjistrimin e OSHC-ve që kanë ndikuar negativisht në aftësinë e tyre për të marrë pjesë në procesin EITI; kufizimet ligjore ose administrative për qasjen në fonde që kanë parandaluar OSHC-të të ndërmarrin aktivitete lidhur me procesin e EITI; çështjet ligjore ose administrative që parandalojnë OSHC-të të mbajnë takime në lidhje me procesin EITI, pengesat ligjore ose administrative për shpërndarjen e informacionit dhe të komenteve publike mbi procesin EITI, etj.
- Çdo provë që sugjeron se të drejtat themelore të përfaqësuesve të shoqërisë civile janë cenuar në lidhje me zbatimin e procesit të EITI, të tilla si kufizimet në lirinë e shprehjes ose lirinë e lëvizjes.

2.3 Bashkëpunimi: Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë në gjendje të komunikojnë dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në lidhje me procesin EITI.

Bordi dhe vlerësuesit e EITI do të marrin në konsideratë shkallën në të cilën:

- Përfaqësuesit MSG të shoqërisë civile kërkojnë dhe nuk kufizohen nga angazhimi i OShC-ve të tjera që nuk janë pjesë e MSG-ve, përfshirë kapjen e kontributeve të tyre në diskutimet e MSG-ve dhe komunikimin e rezultateve të diskutimeve të MSG-ve.

- Kanalet zyrtare ose joformale të komunikimit midis anëtarëve MSG të shoqërisë civile dhe anëtarë votues të shoqërisë civile, më të shumtë në numër, nuk janë të kufizuar.
- Përfaqësuesit MSG të shoqërisë civile nuk kanë qenë të kufizuar të zgjerojnë pjesëmarrjen e shoqërisë civile, përfshirë diskutimet rreth përfaqësimit të MSG-ve dhe procesit EITI.

2.4 Angazhimi: Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë në gjendje të angazhohen plotësisht, në mënyrë aktive dhe efektive, në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit EITI.

Bordi dhe vlerësuesit e EITI do të marrin në konsideratë shkallën në të cilën:

- Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë në gjendje të kontribuojnë plotësisht në procesin EITI. Kjo mund të përfshijë dëshmi të kontributeve dhe advokimit të diskutimeve kryesore të MSG-ve për çështje të tilla si: objektivat dhe aktivitetet e planit të punës, qëllimi i procesit të raportimit EITI, miratimi i Raporteve EITI, vetë-vlerësimi vjetor i procesit EITI përmes raporteve të aktivitetit vjetor, vlerësimet, etj. Mund të përfshijë gjithashtu prova se shoqëria civile merr pjesë rregullisht në takimet e MSG-ve, grupet e punës së MSG-ve dhe evenimente të tjera EITI, dhe se pikëpamjet e OSHC-ve merren parasysh dhe dokumentohen në proces-verbalet e takimeve të MSG-ve.
- Përfaqësuesit e shoqërisë civile konsiderojnë se kanë kapacitetet e duhura për të marrë pjesë në EITI. Kjo duhet të përfshijë prova që kufizimet teknike, financiare ose të kapaciteteve të tjera që ndikojnë shoqërinë civile, janë marrë në konsideratë dhe se planet për adresimin e këtyre kufizimeve janë rënë dakord dhe/ose janë realizuar, përfshirë sigurimin e qasjes në ngritjen e kapaciteteve ose fondeve.

2.5 Aksesi në vendim-marrje: Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë në gjendje të flasin lirshëm për transparencën dhe çështjet e qeverisjes së burimeve natyrore dhe të sigurojnë që EITI të kontribuojë në debatin publik.

Bordi dhe vlerësuesit e EITI do të marrin në konsideratë shkallën në të cilën:

- Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë në gjendje të përdorin procesin EITI për të promovuar debatin publik, për shembull, përmes ngjarjeve publike, seminareve dhe konferencave, të organizuara nga ose me pjesëmarrjen e shoqërisë civile për të informuar publikun në lidhje me procesin dhe rezultatet e EITI.
- Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë në gjendje të përfshihen në aktivitete dhe debate mbi qeverisjen e burimeve natyrore, përfshirë, për shembull, zhvillimin e analizave dhe advokimit për çështjet e burimeve natyrore, përdorimin e të dhënave EITI, angazhimin në media, zhvillimin e mjeteve për të komunikuar gjetjet e Raporteve EITI, etj.

2.6 Dokumentacioni i disponueshëm nga MSG-të dhe OSHC-të e përfshira në procesin EITI si dhe rezultatet nga konsultimi i drejtpërdrejtë me palët e interesit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, anëtarët e MSG-ve, duhet të merren parasysh gjatë mbledhjes së provave të mësipërme. Për qëllime kontekstuale, Bordi i EITI do të rishikojë mjedisin më të gjerë në të cilin vepron EITI, për shembull, duke iu referuar treguesve ose llojeve të tjerë të vlerësimeve në lidhje me çështjet e trajtuara në 2.1-2.5 më lart.

3. Kufizimet *ad-hoc* ndaj përfaqësuesve të shoqërisë civile

3.1 Pretendimet ose raportet *ad hoc* të kufizimeve të mundshme ose aktuale mbi përfaqësuesit e shoqërisë civile në vendet zbatuese të EITI, duhet që fillimisht të diskutohen dhe trajtohen nga grupt shumëpalëshe, duke mbajtur parasysh shqetësimin për sigurinë e palëve të prekura si rezultat i ngritjes së drejtpërdrejtë të çështjeve të tilla brenda vendit.

3.2 Bordi EITI, përmes Komitetit të tij të Reagimit të Shpejtë, mund të thirret për të inspektuar raste të veçanta dhe për të adresuar shkeljet e pretenduara të Parimeve dhe Dispozitave EITI, sipas rastit. Bordi EITI do të shqyrtojë faktet e këtyre kërkesave, nevojën për të mbështetur Parimet EITI si dhe parimin e trajtimit pa dallime
midis vendeve. Në përputhje me seksionin 4, neni 8.a), “kur Bordi EITI ka shqetësimin se Parimi dhe Dispozitat EITI janë kompromentuar, ai mund të ngarkojë Sekretariatin Ndërkombëtar për mbledhje të dhënash në lidhje me situatën dhe dorëzimin e një raporti Bordit EITI.” Kur ngrihen shqetësime në lidhje me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, Bordi i EITI do të përpiqet të përcaktojë nëse ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë me procesin EITI, përfshirë: (i) dokumentimin e fakteve të çështjes; (ii) mbledhjen e pikëpamjeve të palëve të interesit; dhe (iii) zbatimin e testimeve të përcaktuar në seksionin 2 më lart.

3.3 Në varësi të rrethanave të çështjes, përfshirë shkallën në të cilën mund të vërtetohet se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis shqetësimeve të ngritura dhe procesit EITI, Bordi do të konsiderojë një përgjigje të përshtatshme.
Kjo mund të përfshijë për shembull një letër nga Kryetari ose Bordi i EITI për qeverinë e interesuar, Bordin EITI ose
Misionet e Sekretariatit Ndërkombëtar në vend, komisionimin e vlerësimeve të pavarura, lëshimin e deklaratave të Bordit, miratimin e masave përmirësuese, përfshirë monitorimin e zbatimit, ose thirrjen për vleftësimin e aderimit të një vendi në dispozitat në fjalë. Në përputhje me seksionin 4, neni 8.a), “kur është qartë e qartë se një aspekt i rëndësishëm i Parimeve dhe Dispozitave EITI nuk respektohet nga një vend zbatues, Bordi EITI do ta pezullojë ose heq nga lista atë vend. Në rastet kur Bordi arrin në përfundimin se shqetësimet e vërejtura nuk shkelin ndonjë dispozitë ose nuk janë të lidhura sa duhet me
Procesin EITI, ai do të vendos nëse do të ndërmarrë ndonjë veprim, duke i dhënë përparësi nevojës për të mbështetur Parimet EITI dhe për të siguruar trajtim të njëjtë midis vendeve.

7. Pritshmëritë për shoqëritë që mbështesin EITI

Shoqëritë që mbështesin procesin EITI pritet të:

- Deklarojnë publikisht mbështetjen e tyre për Parimet EITI dhe, përmes promovimit të transparencës në të gjitha industritë nxjerrëse, ndihmojnë debatin publik dhe sigurojnë mundësi për zhvillim të qëndrueshëm.
- Si parim, shoqëritë që mbështesin EITI pritet të deklarojnë publikisht taksat dhe pagesat. Kur zgjedhin të mos e bëjnë diçka të tillë, duhet të tregojnë arsyet pse.
- Deklarojnë plotësisht taksat dhe pagesat e kryera për të gjitha vendet zbatuese EITI.
- Në përputhje me kriteret EITI për përfitimin e pronësisë, të bëjnë publike emrat e pronarëve dhe të marrin masa për të identifikuar pronarët përfitues të partnerëve të drejtpërdrejt në biznesit, përfshirë sipërmarrje e përbashkëta. Shoqëritë e listuara do të bëjnë atë që kërkohet nga rregulloret në fuqi dhe kërkesat e listimit.
- Angazhohen në procese rigoroze prokurimi, përfshirë kryerjen e vigjilencës së duhur në lidhje me partnerët dhe shitësit.
- Mbështesin operacionalizimin e vendimeve të vendeve për të bërë publike licencat dhe kontratat e ardhshme të lidhura që rregullojnë kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve, në përputhje me rekomandimet në Standardin EITI. Shoqëritë pranojnë që përmbushja e një transparence më të madhe duhet të vendoset në kontekstin e respektimit të kontratave dhe kuadrit ligjor në përputhje me Parimet EITI.
- Shoqëritë, duke punuar së bashku me qeveritë, për të ofruar burime natyrore në një mënyrë që është përfitim-sjellëse për shoqërinë dhe komunitetin.
- Ato sigurohen që proceset të jenë përshtatshme për të deklaruar të dhënat e kërkuara për standarde të larta të llogaridhënies.

8. Politika e të dhënave të hapura

Hyrje

1. Kjo politikë përmban rekomandime mbi të dhënat e hapura në zbatimin e EITI brenda fushë-veprimit të dakordësuar të zbatimit të EITI në nivel kombëtar. Ajo plotëson kriteret e të dhënave të hapura sipas Kërkesës 7. Po ashtu, politika mbështetet mbi mësimet që dalin nga zbatimi në nivel kombëtar dhe praktikat më të mira ndërkombëtare[6] dhe inkurajon zbulimin sistematik[7].

2. Në Parimet e EITI deklarohet se "një mirëkuptim publik i të ardhurave dhe shpenzimeve të qeverisë me kalimin e kohës (mund) të ndihmojë debatin publik dhe të informojë zgjedhjen e opsioneve të përshtatshme dhe reale për një zhvillim të qëndrueshëm" (Parimi EITI nr. 4). Standardi EITI kërkon që deklarimet të jenë "të kuptueshme, të promovuara në mënyrë aktive, të aksesueshme nga publiku dhe të kontribuojnë në debatin publik" (Kërkesa EITI 7.1). Përmirësimi i aksesueshërisë, besueshmërisë, rëndësisë, afateve kohore dhe krahasueshmërisë së të dhënave EITI, është thelbësore për realizimin e këtyre objektivave.

3. Për të ndihmuar në jetësimin e Parimeve EITI, Bordi EITI ka rënë dakord që deklarimi sistematik i të dhënave EITI përmes qeverisë dhe sistemeve të ndërmarrjeve tashmë është normë[8]. EITI inkurajon deklarimet rutinë nga entet raportuese në formate të hapur në nivel kombëtar, brenda qëllimit të dakordësuar të zbatimit të Standardit EITI[9].

4. EITI pranon se rrethanat janë të ndryshme për vende të ndryshme dhe jo të gjitha vendet janë në gjendje të kalojnë në të dhëna të hapura me të njëjtën shpejtësi dhe, implikimet financiare duhet të merren në konsideratë, si në terma afat-shkurtër ashtu edhe në terma afat-gjatë. Kërkesa nga publiku dhe përdorimi i të dhënave për të adresuar çështje të politikave publike duhet të merren po ashtu parasysh[10]. Sfidat e aksesit dhe nevojat për informacion të gjinive dhe nën-grupeve të ndryshme të qytetarëve, duhet gjithashtu të merren parasysh.

Objektivat e të dhënave të hapura

5. Të dhënat e hapura nga zbatimi i EITI mund të përmirësojnë transparencën mbi qeverinë dhe aktivitetet e biznesit dhe të rrisin ndërgjegjësimin për mënyrën se si menaxhohen burimet natyrore të vendeve. Ato mund të hedhin dritë mbi pronarët e shoqërive nxjerrëse, zotëruesit e licencave dhe lejeve, kushtet fiskale në fuqi dhe të ardhurat nga nxjerrja, të mbledhura dhe të shpenzuar. Informacione të tilla ofrojnë nxitje të forta që ato para të përdoren në mënyrë më efektive.

---

6 Përfshirë Partneritetin e Hapur Ndërqeveritar, Kartën e të Dhënave të Hapura të G8-ës dhe Aneksin Teknik, Kartën e të Dhënave të Hapura (http://opendatacharter.net/), përcaktimin e termit 'të hapura' (http://opendefinition.org/) dhe Grupin WWW (W3C) për zhvillimin e standardeve të të dhënave (https://www.w3.org/Consortium)

7 Shih https://eiti.org/BD/2018-8

8 Po aty

9 Shih Kriterin 4

10 Qëllimi është "botimi i qëllimshëm", që nënkupton se botimi i të dhënave duhet të synojë zgjidhjen e problemeve specifike të politikës.

6. Të dhënat e hapura janë efektive dhe të dobishme vetëm kur ato jepen në kohë, janë cilësore, adresojnë nevojat dhe pritshmëritë e palëve të interesit. Zbatimi i EITI duhet të promovojë llogari-dhënien dhe qeverisjen e mirë, të rrisë debatin publik dhe angazhimin e qytetarëve, të ndihmojë në luftën kundër korrupsionit përmes llogaridhënies së shtuar të qeverisë dhe, të përmirësojë ofrimin e shërbimeve qeveritare. Sigurimi i aksesit në të dhëna gjithëpërfshirëse mund të fuqizojë individët, mediat, shoqërinë civile dhe biznesin për të bërë zgjedhje më të informuara për shërbimet që marrin dhe standardet që duhet të presin. Të dhënat e hapura mund të jenë një mjet i rëndësishëm për qeveritë në përmirësimin e hartimit të politikave dhe menaxhimit të sektorëve.

7. Aksesi falas dhe, si rrjedhim, ripërdorimi i të dhënave të hapura, janë me rëndësi të konsiderueshme për shoqërinë dhe ekonominë. Ato mund të jenë një burim i rëndësishëm informacioni për grupet shumëpalëshe palë interesi në vendet zbatuese të EITI.

8. Standardet e reja të të dhënave mund të kontribuojnë në bërjen e të dhënave ndërvepruese. Miratimi i standardeve të të dhënave[11] gjithashtu kontribuon në qëndrueshmërinë e botimit të të dhënave, përforcon kapacitetet e qeverive, industrisë dhe shoqërisë civile për të përgatitur dhe publikuar të dhëna përmes aksesit në mjetet dhe burimet ekzistuese dhe, mund t'i vijë në ndihmë përdorimit dhe analizës së të dhënave, aty ku standardet janë hartuar me kujdes dhe janë formuar komunitete përdoruesih.

Zbatimi i politikës së të dhënave të hapura në EITI

9. Vendet zbatuese të EITI inkurajohen të:

   a) publikojnë, në mënyrë sistematike, të dhëna të hapura, duke përfshirë politikat dhe strategjitë e të dhënave të hapura në njësitë raportuese të përfshira në raportimin EITI, për të siguruar të dhëna në kohë dhe me cilësi, qasje dhe efektivitet të kostos së shpërndarjes së të dhënave;

   b) duke punuar me përdoruesit[12], identifikijnë grupe prioritare të të dhënave dhe formën që duhet të marrë shpërndarja e tyre;

   c) mbajnë parasysh nevojat e ndryshme të përdoruesve dhe sfidat e aksesit, bazuar në përfaqësimin gjinor, etnik dhe gjeografik;

   d) sigurojnë që të dhënat të ofrohen me imtësi, të jenë të lexueshme nga mjeti i përdorur dhe të plota, në mënyrë që përdoruesit të kenë informacion të mjaftueshëm për të kuptuar pikat e forta, të dobëta, kufizimet analitike dhe kërkesat e sigurisë, si dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave;

   e) sigurojnë të dhëna sa më shpejt të jetë e mundur, lejojnë përdoruesit të japin feedback dhe më pas të bëjnë rivlerësimet e duhura për të siguruar standardet më të larta të cilësisë së të dhënave të hapura.

11 Shembujt përfshijnë: për pronarët përfitues, standardi i të dhënave mbi pronarët përfitues po merr jetë si standardi i të dhënave të hapura (http://standard.openownership.org); ndërsa për kontratat po adoptohet Standardi i Kontraktimit të të Dhënave të Hapura (http://standard.open-contracting.org/).

12 Termi përdorues mund t'i referohet qytetarëve, medias, botës akademike dhe natyrisht agjencive të tjera qeveritare që përdorin të dhëna nga agjenci të tjera për ofrimin e shërbimeve të tyre.

f) sigurojnë të dhëna mbi bazën e licencave të hapura, mundësisht CC 4.0[13], që iu mundësojnë përdoruesve marrjen dhe ri-përdorimin me lehtësi të tyre[14];

g) ndajnë ekspertizën teknike dhe përvojën me vendet e tjera për të maksimizuar potencialin e të dhënave të hapura në një mënyrë gjithëpërfshirëse shoqërore;

h) punojnë për të rritur aftësinë e të kuptuarit të të dhënave të hapura dhe për të inkurajuar njerëzit, siç janë zhvilluesit e aplikacioneve dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e promovimit të të dhënave të hapura, të zbulojnë rëndësinë e të dhënave të hapura;

i) sigurojnë që të dhënat ndërthuren me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare[15], përfshirë miratimin e standardeve të të dhënave të miratuara nga Bordi EITI dhe udhëzime shtesë të ofruara nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI;

j) aty ku është e mundur, mbështesin ndërlidhjen e referimit e të dhënave me grupe të tjera të të dhënave, duke përdorur identifikues unikë, të vazhdueshëm dhe publik për njësitë tregtare dhe qeveritare;

k) mbajnë parasysh infrastrukturën teknike për të dhënë dhe përdorur të dhënat e hapura[16];

l) marrin parasysh qeverisjen dhe qëndrueshmërinë e politikave të të dhënave të hapura për të siguruar që njësitë raportuese të kenë një kujdestar të të dhënave, të dhënat të ruhen dhe standardet e sigurisë të jenë në fuqi.

Angazhimi me komunitetin e të dhënave të hapura

10. Për të mësuar nga dhe formësuar praktikat më të mira të të dhënave të hapura qeveritare, vendet anëtare të EITI inkurajohen të mbështesin Kartën e të Dhënave të Hapura[17] dhe iniciativat e tjera të lidhura me të[18];

11. Për të transferuar mësimet e nxjerra nga vendet EITI dhe për të marrë nga përvoja ndërkombëtare, Sekretariati Ndërkombëtar EITI duhet të organizohet në grupe pune që përqendrohen në të dhëna të hapura, kur ato konsiderohen plotësuese[19].

---

13 Shih https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/ dhe https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/legalcode

14 Shih "Rekomandime për licencimet" dhënë nga Open Knowledge International https://research.okfn.org/avoiding-data-use-silos/#the-licensing-process

15 Shih, p.sh., Drejtorinë e Standardeve të të Dhënave të Hapura http://datastandards.directory/

16 Infrastruktura teknike lidhet me teknologjinë e informacionit dhe aftësitë e nevojshme për të mundësuar mbledhjen dhe qërimin e të dhënave, si dhe ndërlidhjen me grupe të tjera të dhënash dhe botimin e tyre. Hartëzimi i ekosistemeve të të dhënave mund të jenë një mënyrë për të skicuar infrastrukturën teknike dhe aktorët në lidhje me mbledhjen, trajtimin dhe publikimin e të dhënave. Shih p.sh., udhëzuesin e Institutit të të Dhënave të Hapura https://theodi.org/project/mapping-data-ecosystems/ dhe parimet DFID për zhvillimin digjital: https://digitalprinciples.org/principle/understand-the-existing-ecosystem/

17 Shih Kartën e të Dhënave të Hapura: https://opendatacharter.net/endorse-the-charter/

18 Shih udhëzimet "Parimet e Zhvillimit Digjital": https://digitalprinciples.org/

19 Për shembull, grupi i punës për zbatimin e Kartës së të Dhënave të Hapura, i cili zhvillon mjete dhe burime për të mbështetur qeveritë në zbatimin e të dhënave të hapura dhe promovon dhe lehtëson shkëmbimin e përvojave mes kolegëve në të gjithë vendet dhe organizatat. Shih https://opendatacharter.net/who-we-are/për më shumë informacion.

KAPITULLI II
Qeverisja dhe Menaxhimi

EITI ka evoluar në një standard global, duke mundësuar një platformë për debate dhe reforma më të gjera. Po ashtu, edhe qeverisja dhe menaxhimi i vetë EITI ka evoluar. Ajo drejtohet nga një shoqatë anëtare jo-fitimprurëse sipas ligjit norvegjez. Është Akti i Themelimit të Shoqatës EITI që ofron një kuadër qeverisëse për EITI.

EITI organizon një Konferencë Globale të paktën çdo tre vjet, në mënyrë që të sigurojë një forum ndërkombëtar për palët e interesit në punën e EITI, për të çuar përpara objektivat e saj. Krahas këtyre Konferencave, por në përmasa më të vogla, zhvillohet Asambleja e Anëtarëve, me tre grupet me të drejtë vote - vendet (zbatuese dhe mbështetëse), shoqëritë (përfshirë institucionet financiare) dhe organizatat e shoqërisë civile.
Votat e tre anëtarëve me të drejtë vote kanë të njëjtën peshë. Një nga detyrat kryesore të Asamblesë së Anëtarëve është emërimi i Bordit EITI. Zgjedhësit bien dakord ndërmjet tyre për anëtarësimin e tyre në Shoqatë dhe kë dëshirojnë të emërojnë në Bordin EITI.

Në periudhën midis këtyre Konferencave dhe Asambleve të Anëtarëve, është Bordi EITI ai që mbikëqyr aktivitetet e EITI, përmes takimeve të rregullta të Bordit, takimeve të komisioneve dhe qarkoreve të shpeshta të Bordit. Bordi EITI ka 21 anëtarë, me anëtarë të ndryshëm me të drejtë vote që kanë të drejtë përfaqësimi.

Sekretariati Ndërkombëtar EITI është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të Shoqatës EITI. Vendeve zbatuese të EITI iu ofrohet një sasi e konsiderueshme asistence teknike, si nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI, ashtu edhe nga organizata të tjera multi-laterale, bi-laterale dhe jo-qeveritare.

Ky seksion përmban dokumentet kryesore të qeverisjes së EITI në nivelin ndërkombëtar:

- Akti i Themelimit të Shoqatës, që do të miratohet në Asamblenë e Anëtarëve të datës 17 qershor 2019
- Dokumenti i Politikës së Hapur, i cili përcakton se si vetë EITI duhet të jetë transparente
- Udhëzimet e anëtarëve votues të EITI gjenden te eiti.org/governance
- Kodi i Sjelljes së Shoqatës EITI

9. Akti i Themelimit

Subjekt miratimi nga mbledhja e anëtarëve të EITI në 17 qershor 2019. Nëse nuk miratohet, mbetet në fuqi Akti i vitit 2016.

NENI 1 EMRI

1. Emri i shoqatës është "Shoqata për Iniciativën e Transparencës së Industrive Nxjerrëse (EITI)" (këtej e tutje referuar si "Shoqata EITI").

NENI 2 SFONDI HISTORIK DHE OBJEKTIVI

1. Shoqata EITI është një iniciativë ndërkombëtare shumëpalëshe dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga qeveritë dhe agjencitë e tyre; sipërmarrjet e naftës, gazit dhe minierave; sipërmarrjet e administrimit të aseteve dhe fondet e pensionit (në vijim referuar si "Investitorë Institucional") dhe grupet lokale të shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare ndërkombëtare.
2. Objektivi i Shoqatës EITI është t'i kthejë Parimet EITI dhe Kërkesat EITI, në standarde të pranuar ndërkombëtarisht në lidhje me transparencën në sektorët e naftës, gazit dhe minierave, duke pranuar që forcimi i transparencës së të ardhurave nga burimet natyrore mund të zvogëlojë korrupsionin dhe se, të ardhurat nga industritë nxjerrëse, mund të transformojnë ekonominë, ulin varfërinë dhe rrisin standardet e jetesës së popullatave të tëra në vendet e pasura me burime.

NENI 3 PERSONI JURIDIK ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

1. Shoqata EITI është një shoqatë jofitimprurëse e themeluar sipas ligjit norvegjez ("forening").
2. Anëtarët e Shoqatës EITI nuk do të jenë përgjegjës, individualisht ose kolektivisht, për asnjë nga borxhet, detyrimet ose detyrimet e Shoqatës EITI.

NENI 4 ORGANIZIMI

1. Organet e përhershme institucionale të Shoqatës EITI janë:
   i. Asambleja e Anëtarëve të EITI, e cila mbahet njëkohësisht me Konferencën e EITI;
   ii. Bordi EITI, i udhëhequr nga Kryetari i EITI;
   iii. Sekretariati EITI, i drejtuar nga Drejtori Ekzekutiv;
2. Bordi EITI mund të krijojë komitete, si parashikuar nga neni 14;
3. Shoqatës EITI vepron në mënyrë transparente dhe inkurajon diversitetin gjinor, të kombësive dhe kulturave.

NENI 5 ANËTARËSIA DHE ANËTARËT ME TË DREJTË VOTE

1. Anëtarët e Shoqatës EITI janë përfaqësues personal të vendeve (që do të thotë shteteve), sipërmarrjeve, organizatave apo personave juridik që emërohen nga anëtarët me të drejtë vote, si përcaktuar në Nenet 5 (2) dhe (3).

2. Anëtarët janë të organizuar në tre Grupe Zgjedhësish, të cilat janë:
   i. Zgjedhësit e Vendeve, ku përfshihen:
      a) Vendet Zbatuese, domethënë shtetet, të cilat janë klasifikuar nga Bordi EITI si të tilla; dhe
      b) Vendet Mbështetëse, domethënë shtetet ose bashkimi i shteteve, që mbështesin objektivin e Shoqatës EITI si përcaktuar nga Bordi EITI.
   ii. Zgjedhësit e Sipërmarrjeve, ku përfshihen:
      a) Sipërmarrjet në sektorin nxjerrës që janë zotuar të mbështesin objektivin e Shoqatës EITI, si përcaktuar nga Bordi EITI dhe shoqatat që përfaqësojnë këto sipërmarrje;
      b) Investitorët institucionalë që janë zotuar të mbështesin objektivin e Shoqatës EITI, si përcaktuar nga Bordi EITI; dhe
      c) Tregtarët e mallrave që janë zotuar të mbështesin objektivin e Shoqatës EITI, si përcaktuar nga Bordi EITI.
   iii. Zgjedhësit e Organizatave të Shoqërisë Civile, ku përfshihen organizatat joqeveritare, rrjetet globale të veprimit ose koalicionet që mbështesin objektivin e Shoqatës EITI, si përcaktuar nga Bordi EITI.

3. Çdo Grup Zgjedhësish vendos për rregullat e tij që rregullojnë emërimet e Anëtarëve të Shoqatës EITI. Anëtarësia do të kufizohet në sa vijon:
   i. Për Zgjedhësit e Vendeve: deri në një përfaqësues nga secili Vend Zbatues dhe secili Vend Mbështetës (ose bashkimet e tyre);
   ii. Për Zgjedhësit e Sipërmarrjeve: deri në një përfaqësues nga ço sipërmarrje dhe shoqatë që i përfaqëson ato dhe, maksimumi pesë përfaqësues nga Investitorët Institucionalë;
   iii. Për Zgjedhësit e Organizatave të Shoqërisë Civile: deri në një përfaqësues nga secila Organizatë e Shoqërisë Civile.

4. Zgjedhësit mund të zëvendësojë cilindo Anëtar të tyre të emëruar në çdo kohë. Zgjedhësit do të informojnë Sekretariatin EITI mbi Anëtarët e tyre në çdo kohë.

5. Bordi EITI mund të ndërpresë Anëtarësinë e një Anëtari të Shoqatës EITI, nëse:
   i. Anëtari, ose vendi ose subjekti tjetër që Anëtari përfaqëson, nuk respekton aktin e Themelimit; ose
   ii. Anëtari, ose vendi ose subjekti tjetër që Anëtari përfaqëson, i ka zhvilluar aktivitetet në një mënyrë që konsiderohet paragjykuese ose në kundërshtim me Parimet EITI.

6. Sipas Nenin 5 (5), vendimet e Bordit EITI, mund të apelohen nga çdo Anëtar në Asamblenë e Anëtarëve për një vendim përfundimtar.

NENI 6 KONFERENCA EITI

1. Konferencat EITI do të mbahen të paktën çdo tre vjet, me qëllim që të sigurohet një forum për palët e interesit të EITI, të gjithë me interes në Shoqatën EITI, për të çuar më tej objektivin e Shoqatës EITI dhe për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi politikat dhe strategjitë e Shoqatës EITI. Kryetari i EITI do të jetë kryetari i Konferencës. Konferenca EITI është një organ jo-qeverisës i Shoqatës EITI.

2. Anëtarët e EITI, Bordi EITI dhe Sekretariati EITI, kanë të drejtë të marrin pjesë ose të përfaqësohen në Konferencën EITI. Palët e tjera të interesit të EITI duhet gjithashtu të ftohen por, në secilin rast, në masën që është mjaft praktike të bëhen rregullime për ta bërë këtë siç vendoset nga Bordi i EITI.

3. Konferenca EITI do të thirret nga Bordi EITI në faqen e internetit të EITI dhe me njoftim me shkrim Anëtarëve dhe Zgjedhësve, të paktën katër javë përpara. Njoftimi me shkrim do të përfshijë agjendën e Konferencës EITI.

4. Konferenca EITI do të:
   i. Sigurojë një platformë të rëndësishme dhe të dukshme për debat, advokim, mbledhje të vazhdueshme fondesh dhe përfshirjen e aktorëve të rinj të EITI;
   ii. Rishikojë progresin, bazuar në raportet e aktiviteteve për periudhat ndërmjet dy Asambleve të zakonshme të Anëtarëve;
   iii. Ofrojë sugjerime Bordit EITI në lidhje me aktivitetet e Shoqatës EITI deri në Asamblenë e ardhshme të zakonshme të Anëtarëve;
   iv. Mobilizojë dhe ruaj një nivel të lartë koordinimi, angazhimin politik dhe dëshirën për të arritur objektivin e Shoqatës EITI; dhe
   v. Sigurojë një kanal jo formal komunikimi për palët e interesit të EITI që nuk përfaqësohen zyrtarisht diku tjetër në strukturat e qeverisjes së Shoqatës EITI.

5. Pikëpamjet mbi çështjet e paraqitura në Nenin 7(4) më sipër, mund të shprehen në një Deklaratë Jo-detyruese Rezultatesh, e cila do të miratohet nga Konferenca EITI dhe do t'i komunikohet Asamblesë së Anëtarëve të EITI dhe Bordit të EITI. Konferenca EITI do të bëjë çdo përpjekje për t'i miratuar vendimet me konsensus. Duke marrë parasysh pikëpamjen e palëve të interesit të EITI, Kryetari i EITI mund të vendosë se nevojitet votim. Çdo palë interesi e EITI, përveç Anëtarëve të Bordit EITI në këtë cilësi dhe Sekretariatit, ka nga një votë. Vendimet e Konferencës EITI miratohen me shumicën e thjeshtë të të pranishmëve dhe votuesve.

NENI 7 ASAMBLEJA E ANËTARËVE TË SHOQATËS EITI

1. Organi drejtues i Shoqatës EITI është Asambleja e Anëtarëve EITI.
2. Asambleja e Anëtarëve të EITI përbëhet nga Anëtarët e Shoqatës EITI.
3. Asambletë e zakonshme të Anëtarëve të EITI do të mbahen të paktën çdo tre vjet, paralel me Konferencën EITI. Asambleja e e zakonshme e Anëtarëve të EITI do të thirret nga Bordi EITI me njoftim me shkrim të Anëtarëve të paktën katër javë përpara.
4. Asambletë e Jashtëzakonshme të Anëtarëve mund të thirre nga Bordi EITI, me njoftim me shkrim të Anëtarëve të paktën tre javë përpara. Bordi EITI do të sigurojë që Asambletë e Jashtëzakonshme të Anëtarëve të mbahen brenda katër javësh nga marrja nga Kryetari EITI i kërkesës për të mbajtur një Asamble të tillë.
5. Anëtarët që dëshirojnë të marrin pjesë në një Asamble, duhet të njoftojnë Sekretariatin EITI brenda datës së treguar në thirrje. Anëtarët mund të përfaqësohen në Asamblenë e Anëtarëve përmes një prokure të shkruar. Prokura mund të përfshijë gjithashtu udhëzime specifike për votimin.

   Prkurat e nënshkruara rregullisht duhet të merren nga Sekretariati EITI brenda datës së treguar tek thirrjet.
6. Kryetari i EITI do të jetë edhe kryetari i Asamblesë së Anëtarëve të EITI.
7. Kuorumi i Asamblesë së Anëtarëve do të jetë minimumi një e treta e Anëtarëve dhe duhet të përfshijë të paktën një të tretën e Anëtarëve nga secili Grup Zgjedhor.
8. Asambleja e Anëtarëve do të bëjë çdo përpjekje për t'i miratuar vendimet me konsensus. Në rast se kërkohet votim, vendimet do të miratohen me shumicë të cilësuar që kërkon mbështetjen e të paktën dy të tretave të votave totale të dhëna dhe, duhet të përfshijnë të paktën një të tretën e votave të dhëna nga Anëtarët që përfaqësojnë secilën Grup Zgjedhësish. Numri i përgjithshëm i votave për anëtarët e secilit grup zgjedhor do të jetë i barabartë dhe përcaktohet si më poshtë:
   i. Anëtarët nga Grupi Zgjedhor i Vendeve do të kenë nga një votë secili; dhe
   ii. Votat për Anëtarët nga Grupet Zgjedhore të Sipërmarrjeve dhe të Organizatave të Shoqërisë Civile, do të përcaktohen duke pjesëtuar totalin e votave të Vendeve me numrin e Anëtarëve të Grupeve Zgjedhëse të Sipërmarrjeve dhe Shoqërisë Civile përkatësisht.
   iii. Kryetari i EITI do të shpallë numrin e votave për secilin Anëtar nga grupet e ndryshme votuese, përpara votimit.

NENI 8 FUNKSIONET E ASAMBLESË SË ANËTARËVE TË SHOQATËS EITI

1. Asambleja e Anëtarëve EITI:
   i. Miraton raportin e aktiviteteve, llogaritë dhe planin e veprimtarisë së Bordit EITI;
   ii. Zgjedh Anëtarët, dhe Alternativat për secilin Anëtar, të Bordit EITI, të emëruar nga Zgjedhësit;
   iii. Zgjedh Kryetarin EITI, me propozimin e Bordit EITI; dhe

iv. Shqyrton çdo çështje tjetër, në vijim të kërkesave të Anëtarëve. Këto kërkesa do t'i paraqiten me shkrim Kryetarit të EITI në kohë, në mënyrë që çdo çështje të përfshihet në rendin e ditës së Asamblesë së Anëtarëve të EITI, të deklaruar në thirrje.

NENI 9 BORDI EITI

1. Organi ekzekutiv i Shoqatës EITI është Bordi EITI, i zgjedhur nga Asambleja e Anëtarëve të EITI dhe që vepron nën udhëzimet e Asamblesë së Anëtarëve të EITI.

2. Në mënyrë që të pasqyrojë natyrën shumëpalëshe të Shoqatës EITI, Bordi EITI do të përbëhet nga 20 Anëtarë ("Anëtarët e Bordit"), si më poshtë:
   i. Kryetari;
   ii. Nëntë Anëtarë të Bordit që janë Anëtarë të Shoqatës EITI nga Zgjedhësit e Vendeve, nga të cilët, maksimumi tre Anëtarë të Bordit, duhet të përfaqësojnë Vendet Mbështetëse dhe pjesa tjetër Vendet Zbatuese;
   iii. Gjashtë Anëtarë të Bordit që janë Anëtarë të Shoqatës EITI, nga Zgjedhësit e Sipërmarrjeve, nga të cilët maksimumi një duhet të përfaqësojë Investitorët Institucionalë;
   iv. Pesë Anëtarë të Bordit që janë Anëtarë të Shoqatës EITI nga Zgjedhësit e Organizatave të Shoqërisë Civile.

3. Përfundimi i mandatit për Anëtarët e Bordit ka efekt nga momenti i përfundimit të Asamblesë së zakonshme të Anëtarëve të EITI të mbajtur pas emërimit të tyre, por do të mund të ri-emërohen në atë Takim të Anëtarëve të EITI.

4. Zgjedhësit mund të propozojnë dhe Asambleja e Anëtarëve të EITI mund të zgjedhë, një Anëtar alternativ të Bordit (një "Alternativë") për secilin Anëtar të Bordit që Zgjedhësi ka propozuar. Një Alternativ mund të zëvendësojë një Anëtar Bordi. Nëse nuk ka Alternativa, Zgjedhësit përkatës do të emërojnë një Anëtar të ri të Bordit dhe një Alternativë.

5. Nëse një nga Anëtarët e Bordit mungon në një nga Mbledhjet e Bordit, Alternativa për atë Anëtar Bordi mund të marrë pjesë, të marrë pjesë në diskutime, të votojë dhe, në përgjithësi, të kryejë të gjitha funksionet e Anëtarit të Bordit në fjalë në Mbledhjet e Bordit.

6. Në rast vendi vakant në Bord ndërmjet dy Asambleve të EITI, vendi do të plotësohet nga Alternativa e Anëtarit të Bordit në largim dhe, Grupi përkatës i Zgjedhësve, do të propozojë një Alternativë të re që do të zgjidhet nga Bordi. Si alternativë, Grupi Zgjedhor në fjalë mund të emërojë një Anëtar të ri Bordi që do të zgjidhet nga Bordi.

7. Shoqata EITI do të mundësojë sigurimin e përgjegjësive të Anëtarëve të Bordit. Kushtet dhe afatet duhet të miratohen nga Bordi EITI.

8. Bordi EITI mund të vendosë që një Anëtar Bordi që përfaqëson një vend zbatues që është pezulluar gjatë mandatit, mund të mbajë statusin e Anëtarit të Bordit, por të mos përfshihet në aktivitetet e Bordit gjatë periudhës së pezullimit. Në rast se pezullimi është në fuqi për më shumë se një vit, Bordi i EITI mund të vendosë që anëtarësia në Bordi të ndërpritet.

NENI 10 VËZHGUESIT EITI

1. Përfaqësuesit nga organizatat përkatëse ndërkombëtare, të tilla si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe palët e tjera të interesit, duhet të ftohen nga Bordi EITI për të marrë pjesë në Asambletë e Bordit EITI dhe në Asambletë e Anëtarëve si vëzhgues, kur është e mundur. Ata nuk kanë të drejtë vote, por mund të ftohen të shprehin pikëpamjet e tyre për çështje specifike. Bordi EITI mund të vendosë që çështje të caktuara duhet të diskutohen pa praninë e vëzhguesve.

NENI 11 KRYETARI I SHOQATËS EITI

1. Kryetari i EITI zgjidhet në Asamblenë e Anëtarëve të EITI. Bordi i EITI, përpara çdo Asambleje të Anëtarëve të EITI, rekomandon një kandidat për Kryetar të EITI për periudhën pas asaj Asambleje të Anëtarëve të EITI. Mandati i Kryetarit të EITI mund të rinovohet vetëm një herë.

2. Kryetari i EITI:
   i. Vepron si kryetar i Asamblesë së Anëtarëve të EITI;
   ii. Vepron si kryetar i Asamblesë së Bordit të EITI;
   iii. Paraqet raportin e Bordit të EITI në Konferencën e EITI dhe në Asamblenë e Anëtarëve të EITI;
   iv. Përfaqëson Bordin e EITI në çështjet e jashtme;
   v. Ndjek me Sekretariatin e EITI zbatimin e rezolutave të Bordit EITI; dhe
   vi. Synon të nxisë marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet palëve të interesit të EITI.

3. Nëse Kryetari i EITI nuk mund të kryesojë një Asamble Bordi, Anëtarët e pranishëm të Bordit mund të caktojnë një Anëtar tjetër të Bordit për të kryesuar atë Asamble.

NENI 12 FUNKSIONET E BORDIT EITI

1. Bordi EITI vepron në interesat më të mira të Shoqatës EITI në çdo kohë. Bordi EITI ushtron kompetencat ekzekutive të EITI
   Shoqata i nënshtrohet rezolutave të Asamblesë së Anëtarëve të EITI, duke përfshirë funksionet kryesore të mëposhtme:
   i. Merr parasysh çështjet e përgjithshme dhe specifike të politikave që prekin Shoqatën EITI;
   ii. Bie dakord për planet e punës dhe buxhetin e Shoqatës EITI;
   iii. Bie dakord për aranzhimet për Konferencat EITI dhe Asambletë e Anëtarëve të EITI;
   iv. Paraqet (përmes Kryetarit të EITI) raportin e aktivitetit dhe planin e aktivitetit për Konferencën EITI dhe merr miratimin e tij në Asamblenë e Anëtarëve të EITI;
   v. Paraqet (përmes Kryetarit të EITI) llogaritë vjetore dhe raportet e auditimit për periudhat kontabël që nga Asambleja e fundit e Anëtarëve të EITI;
   vi. Angazhon Drejtorin Ekzekutiv;
   vii. Mbikëqyr dhe drejton (përmes Kryetarit të EITI) punën e Sekretariatit të EITI;

viii. Garanton se natyra shumëpalëshe e Shoqatës EITI ruhet dhe pasqyrohet plotësisht në Shoqatën EITI në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe në Komitetet e saj;

ix. Monitoron dhe mbështet zbatimin e EITI në vendet zbatuese të saj dhe vendos procedurat lidhur me procesin e validimit, duke përfshirë ankesat, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, çështjen e çregjistrimit të një vendi dhe procedurat e apelimit;

x. Miraton procedura dhe rregulla më të hollësishme për menaxhimin dhe funksionimin e Shoqatës EITI duke përfshirë përmbajtjen e planeve të punës në vend dhe planeve të punës së shoqërive, procesin e validimit, menaxhimin e fondeve, pagesat për projekte, mallra dhe shërbime, auditimin dhe raportimin si dhe miratimin e projekteve;

xi. Rekomandon një kandidat për Kryetar të EITI përpara çdo Asambleje të Anëtarëve të EITI; dhe

xii. Miraton një kod sjelljeje.

NENI 13 KOMITETET E BORDIT EITI

1. Bordi i EITI mund të krijojë komitete për çështjet specifike të mëtejshme. Çdo komitet i tillë duhet të përfshijë dy ose më shumë Anëtarë të Bordit ose zëvendësit e tyre, dhe përbërja e tij, për aq sa është e arsyeshme, duhet të pasqyrojë natyrën shumëpalëshe të Shoqatës EITI. Kushtet mbi të cilat funksionon ky komitet duhet të regjistrohen në Regjistrin e Procesverbaleve.

NENI 14 AKTIVITETET DHE MBLEDHJET E BORDIT EITI

1. Bordi EITI mblidhet të paktën dy herë në vit. Në bazë të rrethanave, Asambletë e Bordit të EITI mund të mbahen përmes konferencave telefonike. Të paktën një Asamble në vit e Bordit të EITI mbahet personalisht.

2. Asambleja e Bordit njoftohet me shkrim nga Kryetari i EITI të paktën 14 ditë më parë. Çdo periudhë më e shkurtër njoftimi kërkon pëlqimin me shkrim të të gjithë Anëtarëve të Bordit.

3. Anëtarët e Bordit bëjnë çdo përpjekje për t'i miratuar vendimet me konsensus. Duke marrë parasysh pikëpamjen e Anëtarëve të Bordit, Kryetari i EITI mund të vendosë se nevojitet votim. Çdo Anëtar Bordi i EITI ka të drejtën e një vote. Votimi mund të bëhet përmes një prokure të shkruar.

4. Nuk mund të merret asnjë vendim nga Asambleja e Bordit përveç nëse ekziston një kuorum në kohën e miratimit të vendimit. Të paktën dy të tretat e Anëtarëve të Bordit, me të paktën dy Anëtarë Bordi nga Grupi Zgjedhor i Vendeve (një Vend Zbatues dhe një Vend Mbështetës), një Anëtar Bordi nga Grupi Zgjedhor i Organizatave të Shoqërisë Civile dhe një anëtar bordi nga Grupi Zgjedhor i Shoqërive vendosin një kuorum.

5. Në rast se kërkohet votim, vendimet miratohen me shumicë të cilësuar që kërkon 13 vota në favor të vendimit dhe duhet të përfshijnë të paktën një të tretën e votave të Anëtarëve të Bordit nga secili Grup Zgjedhor.

6. Një Anëtar Bordi nuk voton lidhur me ndonjë çështje ose marrëveshje në të cilin ai ose ajo është i/e interesuar drejtpërdrejt, ose nëse ka ndonjë

rrethanë tjetër të veçantë që është e prirur për të dëmtuar besimin në paanësinë e tij ose të saj. Një Anëtar Bordi i'a deklaron këto interesa me shkrim Bordit të EITI sa më shpejt që të jetë e mundur pasi ai/ajo të vihet në dijeni për diçka të tillë. Një Anëtar Bordi nuk llogaritet në kuorumin e pranishëm kur merret vendim për një çështje rreth së cilës ai Anëtar Bordi nuk ka të drejtë të votojë.

7. Bordi i EITI mund të vendosë procedura lidhur me proceset e vendimmarrjes jashtë Asambleve të Bordit. Çdo vendim i marrë jashtë Asambleve të Bordit në përputhje me këto procedura duhet të regjistrohet në Procesverbalin e Asamblesë së Bordit pas marrjes së vendimit.

8. Shoqata EITI mund të angazhohet nga jashtë me nënshkrimin e përbashkët të të gjithë Anëtarëve të Bordit. Bordi i EITI mund të zgjedhë vetëm Kryetarin, ose dy apo disa Anëtarë Bordi për të pasur të drejtën e nënshkrimit, nga të cilët të dy mund të nënshkruajnë së bashku.

NENI 15 SEKRETARIATI I SHOQATËS EITI

1. Sekretariati i EITI ("Sekretariati") përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv dhe personeli tjetër i nevojshëm. Anëtarët e Sekretariatit kontraktohen drejtpërdrejt ose punësohen nga Anëtarët e EITI.

2. Sekretariati është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të Shoqatës EITI, duke përfshirë mbështetjen për vendet zbatuese, nën drejtimin e Bordit të EITI përmes Kryetarit të tij.

3. Sekretariati mban një Regjistër të përditësuar të Anëtarëve në çdo kohë.

4. Sekretariati i regjistron këto nene të Shoqatës dhe çdo ndryshim të tyre.

5. Sekretariati mban Procesverbalet e të gjitha Asambleve të Bordit të EITI, Asambleve të Anëtarëve dhe Konferencave të EITI në një Regjistër Procesverbali. Të gjitha këto procesverbale publikohen në faqen e uebit të EITI. Këto procesverbale regjistrojnë emrat e të pranishmëve, vendimet e marra në asamble dhe, kur është e përshtatshme, arsyet për vendimet e marra.

NENI 16 DREJTORI EKZEKUTIV I SEKRETARIATIT EITI

1. Sekretariati drejtohet nga një Drejtor Ekzekutiv me kohë të plotë, i cili do të menaxhojë drejtimin e përditshëm të Shoqatës EITI, duke përfshirë zgjedhjen e personelit të nevojshëm, mbikëqyrjen e zhvillimit të Shoqatës EITI dhe sigurimin e mbështetjes për Bordin e EITI. Drejtori Ekzekutiv i raporton Bordit të EITI përmes Kryetarit dhe është përgjegjës për aktivitetet e Sekretariatit.

2. Drejtori Ekzekutiv, ose i emëruari i tij nga Sekretariati shërben si Sekretar në të gjitha Asambletë e Bordit të EITI, Asambletë e Anëtarëve të EITI dhe Konferencat EITI.

NENI 17 FINANCIMI

1. Shoqata EITI është një shoqatë jofitimprurëse. Fondet e saj përbëhen nga kontribute vullnetare nga kontribuuesit e EITI dhe grante nga donatorë dypalësh dhe shumëpalësh, institucione financiare ndërkombëtare dhe agjenci të tjera, organizata dhe subjekte siç përcaktohet nga Bordi i EITI.

2. Shoqata EITI mund të veprojë gjithashtu përmes kontributeve vullnetare në natyrë.

NENI 18 LLOGARITË EITI, MENAXHIMI I FONDEVE DHE PAGESAT

1. Shoqata EITI mban një llogari bankare të veçantë në emrin e saj, "EITI International Management Account". EITI International Management Account mund të përdoret për çdo aktivitet që bie brenda objektivave të Shoqatës EITI dhe planeve të punës të miratuara nga Bordi i EITI. Fondet mund të aplikohen për administratën dhe shpenzimet e qeverisjes, aktivitetet specifike të vendit dhe aktivitetet shumë-vendore.

2. Bordi i EITI cakton një auditor të jashtëm, të pavarur për të audituar çdo vit EITI International Management Account dhe për t'i paraqitur një raport të shkruar të auditimit Bordit të EITI.

   Bordi i EITI zhvillon rregullime raportimi dhe auditimi lidhur me EITI International Management Account, të cilat përcaktohen në rregullat dhe procedurat shtesë të funksionimit të Shoqatës EITI.

ARTICLE 19 NDRYSHIMET

1. Këto nene të Shoqatës mund të ndryshohen nga Asambleja e Anëtarëve të EITI e thirrur dhe mbajtur, në përputhje me nenin 8, me miratimin e të paktën dy të tretave të Anëtarëve të pranishëm.

   Propozimi për ndryshim do u komunikohet me shkrim të gjithë anëtarëve të EITI katër javë përpara vendimit përkatës.

NENI 20 PROCESI I RISHIKIMIT

1. Rishikimi i rregullimeve të qeverisjes së Shoqatës EITI duhet të ndërmerret nga Bordi i EITI brenda dy vjetësh nga themelimi i Shoqatës.

NENI 21 TËRHEQJA DHE SHPËRBËRJA

1. Çdo Anëtar mund të tërhiqet nga Shoqata EITI në çdo kohë. Kjo tërheqje hyn në fuqi me marrjen e një njoftimi me shkrim të tërheqjes nga Drejtori Ekzekutiv.

2. Shoqata EITI mund të shpërbëhet nga Asambleja e Anëtarëve në përputhje me dispozitat e nenit 8. Propozimi për shpërbërje u komunikohet me shkrim të gjithë anëtarëve të EITI katër javë përpara vendimit përkatës.

3. Në rast shpërbërjeje, asetet e Shoqatës EITI zbatohen për objektiva të ngjashëm me ato të Shoqatës EITI dhe siç përcaktohet nga Bordi i EITI, në varësi të miratimit të Asamblesë së Anëtarëve të EITI.

NENI 22 HYRJA NË FUQI

1. Ky Akt Themelimi hyn në fuqi me themelimin e Shoqatës EITI.

ANEKSI A Parimet EITI

Si në rastin e seksionit 1 të standardit EITI.

ANEKSI B Përdorimi i emrit dhe logos EITI

Emri dhe logoja e EITI janë pronë e EITI. Si rregull i përgjithshëm, përdorimi i emrit ***EITI***, d.m.th. EITI ose Iniciativa e Transparencës së Industrive Nxjerrëse, nënproduktet ose përkthimet, dhe ***logoja*** ose derivatet lokale, inkurajohet dhe lejohet sipas kufizimeve të specifikuara në https://eiti.org/logo-policy.

10. Politika e të dhënave të hapura të EITI

1. **Dokumentet e EITI janë publike, përveç nëse parashikohet ndryshe më poshtë.**

2. Dokumentet e publikuara për EITI për çdo çështje lidhur me çështjet operacionale dhe/ose të biznesit, të cilat për **arsye konkurrence** janë të rëndësishme për t'u mbajtur të fshehta në interes të personit të cilit i përket informacioni, përjashtohen nga aksesi.

   Për shembull, një sekret biznesi normalisht do të përjashtohej nëse publikimi i tij ka potenciali të ndikojë në pozicionin konkurrues të shoqërisë në fjalë.

3. Dokumentet që zbulojnë informacionin e marrë nga një **palë e tretë përjashtohen nga aksesi nëse publikimi i tyre ka të ngjarë të ndikojë në interesat legjitime të asaj pale të tretë.**

   Për shembull, aksesi në dokumente nuk do të jepet nëse mund të rrezikohet siguria personale e palës së tretë dhe/ose familjes së tij dhe/ose ndonjë personi të lidhur ngushtë me palën e tretë në fjalë. Për më tepër, mbrojtja e privatësisë personale gjithashtu do të kualifikohet si interes i ligjshëm dhe për këtë arsye do të përjashtohet.

4. **Dokumentet e brendshme të punës** së EITI përjashtohen nga aksesi.

   Për shembull, dokumentet nga Sekretariati Ndërkombëtar për Bordin e EITI dhe Komitetet e tij normalisht konsiderohen dokumente të brendshme dhe për këtë arsye përjashtohen. Ky përjashtim zbatohet nëse Sekretariati Ndërkombëtar, gjatë përgatitjes së një çështjeje për Bordin e EITI, ka përgatitur ose porositur një analizë ose një raport apo të ngjashëm me to nga një burim i jashtëm. Ndryshe nga sa më sipër, procesverbalet e fundit nga Asambletë e Bordit të EITI si dhe komitetet dhe takimet e grupeve të punës nuk janë dokumente të brendshme. Postat elektronike midis kolegëve të EITI normalisht konsiderohen se janë dokumente të brendshme pune.

5. Informacioni **personal** lidhur me stafin e EITI përjashtohet nga aksesi.

   Për shembull, dokumentet për vlerësimet e bëra lidhur me rekrutimin dhe pushimin nga puna, dhe/ose dokumentet lidhur me vlerësimet e performancës së stafit dhe/ose informacione personale për shembull për shëndetin e anëtarëve të stafit përjashtohen nga aksesi. Nga ana tjetër, të gjitha kontratat, pagat, kompensimi dhe llogaritja e shpenzimeve janë publike.

11.Udhëzimet e anëtarëve votues të EITI

Raporti i Grupit Këshillimor Ndërkombëtar, siç u miratua nga Konferenca e Oslos në tetor 2006, rekomandoi që 'Secili prej grupeve zgjedhore duhet të bien dakord se si dëshirojnë të përfaqësohen në Bordin e propozuar. Kjo kërkon shqyrtim paraprak nga secili anëtar votues për mënyrën se si përcaktohen personat e kualifikuar (i) që të zgjidhen si përfaqësues; dhe (ii) të përfshihen në procesin e përzgjedhjes.

Grupet zgjedhore përcaktohen në nenet e Shoqatës EITI, ku përcaktohet gjithashtu madhësia e anëtarësisë së grupeve zgjedhore në shoqatë dhe numri i vendeve në Bordin e EITI. Disa nga grupet zgjedhore të EITI ndahen në mënyrë informale.

Udhëzimet e përditësuara për grupet zgjedhore dhe nën-grupet zgjedhore janë të disponueshme në faqen e uebit të EITI eiti.org/governance.

12. Kodi i Sjelljes së Shoqatës EITI

1.Objekti

Të gjithë anëtarët e bordit të EITI, zëvendësit e tyre, anëtarët e shoqatës EITI, personeli i sekretariatit (kombëtar dhe ndërkombëtar) dhe anëtarët e grupeve shumëpalëshe (më poshtë referuar si "nëpunësit e EITI") i përmbahen këtij Kodi të Sjelljes.

2. Sjellja personale, integriteti dhe vlerat

Nëpunësit e EITI ruajnë standardet më të larta të integritetit dhe sjelljes etike dhe veprojnë me ndershmëri dhe korrektësi. Sjellja personale dhe profesionale e nëpunësve të EITI duhet, në çdo kohë, të imponojë respekt dhe besim në statusin e tyre si nëpunës të një shoqate që promovon një standard ndërkombëtar për transparencën dhe llogaridhënien dhe duhet të kontribuojë në qeverisjen e mirë të EITI.

Nëpunësit e EITI duhet të përkushtohen për të udhëhequr me shembull dhe duhet të përfaqësojnë interesat dhe misionin e EITI me mirëbesim dhe me ndershmëri, integritet, kujdes të duhur dhe kompetencë të arsyeshme në një mënyrë që ruan dhe rrit besimin e publikut në integritetin e tyre dhe integritetin e EITI, dhe duke siguruar që shoqata e tij/saj me EITI të ruajë marrëdhënie të mira gjatë gjithë kohës.

3. Përputhshmëria

Nëpunësit e EITI i kryejnë detyrat e tyre pranë EITI në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme kombëtare dhe me Rregullat, interesat dhe objektivat e EITI.

4. Respekti për të tjerët

Nëpunësit e EITI respektojnë dinjitetin, nevojat që lidhen me EITI dhe jetën private të të tjerëve dhe ushtrojnë autoritetin e duhur dhe gjykimin e mirë në marrëdhëniet e tyre me kolegët, anëtarët e organeve të tjera të EITI, anëtarët e stafit, publikun e gjerë dhe me këdo që vihen në kontakt gjatë kryerjes së detyrave të tyre në EITI.

5. Profesionalizmi

Nëpunësit e EITI duhet t'i kryejnë detyrat e tyre të caktuara në mënyrë profesionale dhe në kohë dhe duhet të bëjnë përpjekjet më të mira për të marrë pjesë rregullisht në aktivitetet e zhvillimit profesional.

6. Diskriminimi

Nëpunësit e EITI nuk duhet të përfshihen ose të lehtësojnë ndonjë sjellje diskriminuese ose ngacmuese të drejtuar ndaj kujtdo me të cilin vihen në kontakt gjatë kryerjes së detyrave të tyre në EITI.

7. Konfidencialiteti

Nëpunësit e EITI nuk përdorin asnjë informacion që u jepet gjatë detyrës së tyre si nëpunës të EITI dhe të cilat nuk janë publikuar ende në domenin publik në asnjë mënyrë tjetër përveç se në vazhdimësi të detyrave të tyre. Nëpunësit e EITI vazhdojnë të zbatojnë këtë detyrim për dy vjet pas përfundimit të mandatit të tyre.

8. Shpenzimi i burimeve të EITI dhe përdorimi i pronës së EITI

Nëpunësit e EITI respektojnë parimin e raportit cilësi/çmim dhe tregohen të përgjegjshëm në përdorimin e fondeve të dedikuara për EITI. Asnjë nëpunës i EITI nuk keqpërdor pronën ose burimet e EITI dhe do ta mbajë të sigurt pronën e EITI dhe nuk lejon asnjë person që nuk është i autorizuar të zotërojë ose të përdorë këtë pronë.

Nëpunësit e EITI faturojnë vetëm me kosto reale udhëtimi, operacionale ose kosto të tjera që lidhen me përmbushjen e detyrës si nëpunës i EITI. Nëpunësit e EITI i ofrojnë EITI mallra ose shërbime si shitës me pagesë për EITI vetëm pas publikimit të plotë dhe miratimit paraprak nga Bordi EITI ose grupi shumëpalësh i EITI.

9. Konflikti i interesit dhe abuzimi me pozicionin

Nëpunësit e EITI në çdo kohë veprojnë në interesin më të mirë të EITI dhe jo për interesa të tilla si përfitime personale dhe private apo pasurim financiar.

Nëpunësit e EITI shmangin konfliktet e interesave private. Për qëllimet e këtij kodi, një konflikt interesi është një situatë ose rrethanë në të cilën interesat e nëpunësve të EITI ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen objektive dhe të paanshme të detyrave të tyre zyrtare në EITI. Në këtë drejtim, interesat private përfshijnë çdo avantazh për veten, familjet ose të afërmit e tyre.

Nëpunësit e EITI që gjenden në një situatë të tillë duhet të shfajësojnë veten dhe të informojnë Bordin e EITI ose grupin shumëpalësh për këtë shfajësim. Për anëtarët e bordit të EITI zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 5.6 të neneve të Shoqatës EITI.

Në mënyrë specifike, nëpunësit e EITI ndjekin këto udhëzime:

- Shmangin vendosjen (dhe shmangin paraqitjen e vendosjes) e interesit vetjak ose ndonjë interesi të palës së tretë mbi atë të EITI; ndërkohë që marrja e përfitimit të rastësishëm personal ose të palës së tretë mund të rrjedhë domosdoshmërish nga disa aktivitete të lidhura me EITI, ky përfitim duhet të jetë tërësisht i rastësishëm për përfitimin kryesor të EITI dhe qëllimet e tij. Çdo dietë e caktuar, e paguar ose e marrë duhet të bazohet në kosto aktuale të arsyeshme dhe në praktikë të mirë ndërkombëtare[20].
- Përmbahen nga tejkalimi i kompetencave të dhëna. Nëpunësit nuk abuzojnë me detyrën në EITI duke përdorur në mënyrë të pahijshme Shoqatën EITI ose stafin, shërbimet, pajisjet, burimet ose pasurinë e EITI për përfitime ose kënaqësi personale ose të palëve të treta; Nëpunësit e EITI nuk u përfaqësohen palëve të treta në atë mënyrë që autoriteti i tyre si nëpunës të EITI shtrihet më tej sesa është në të vërtetë.
- Nuk angazhohen në asnjë aktivitet personal të jashtëm që mund të ndikojë materialisht negativisht në EITI drejtpërdrejt ose indirekt.

10. Dhuratat, udhëtimet dhe zbavitja

Nëpunësit e EITI nuk kërkojnë ose pranojnë dhurata, shpërblime, udhëtime falas, honorare, prona personale ose ndonjë send tjetër me vlerë nga çdo person ose subjekt që synohet të jetë, ose që mund të perceptohet në mënyrë të arsyeshme të jetë një nxitje e drejtpërdrejtë ose indirekte për të siguruar trajtim të veçantë për këtë donator lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me EITI.

Çdo ofertë ose marrje e dhuratave, udhëtimeve falas ose kompensimeve të tjera mbi vlerën e 100 USD të lidhura drejtpërdrejt ose indirekt me kryerjen e përgjegjësive të EITI duhet t'i deklarohet Bordit të EITI ose grupit përkatës shumëpalësh të EITI (përmes sekretariateve ndërkombëtare ose kombëtare). Çdo ofertë ose marrje e dhuratave që konsiderohet e tepruar duhet të refuzohet. Në rast dyshimi nëse një dhuratë është e tepruar, duhet të konsultohet Sekretariati i EITI ose grupi shumëpalësh. Nëse është e papërshtatshme të refuzohet një ofertë, veçanërisht për shkak se ky refuzim mund të ofendojë dhuruesin, dhurata duhet t'i dorëzohet Sekretariatit të EITI ose grupit shumëpalësh.

11. Zbatimi

Bordi i EITI, grupet përkatëse shumëpalëshe të EITI, sekretariatet ndërkombëtare ose kombëtare janë përgjegjëse për njohjen e nëpunësve të EITI me këtë Kod të Sjelljes dhe për ofrimin e këshillave dhe, nëse kërkohet, për trajnimin lidhur me interpretimin dhe zbatimin e tij. Ata, përfshirë grupet shumëpalëshe të EITI, përgjegjës për njohjen e nëpunësve të EITI me këtë Kod duhet të konfirmojnë çdo vit që nëpunësit e EITI janë njohur me Kodin dhe i raportojnë Bordit përmes Sekretariatit Ndërkombëtar për zbatimin e tij.

20 Për krijimin e kostove të arsyeshme aktuale dhe praktikave të mira ndërkombëtare, palët e interesit mund të dëshirojnë të konsultohen me praktikat e Sekretariatit Ndërkombëtar. Kur Sekretariati siguron dieta (gjë që nuk zbatohet për stafin e tij), ai shpesh ndjek modelin e dietave të Departamentit Amerikan të Shtetit (https://aoprals.state.gov/content.asp?content_id=184&menu_id=78). Për përcaktimin e dietave duhet domosdoshmërish të mbahen parasysh ligjet dhe rregulloret e vendit.

12.Raportimi

Nëpunësit e Zyrave EITI që hasin shqetësime në lidhje me interpretimin, zbatimin ose shkeljen e mundshme të Kodit të Sjelljes, duhet t'i sjellin këto çështje në vëmendje të strukturës më të afërt të EITI. Në rastet kur çështjet sillen në vëmendjen e Bordit EITI, Bordi do të shqyrtojë rrethanat dhe nëse nevojitet marrje masash në përputhje me Parimet EITI, Standardin EITI dhe Statutin e Shoqatës. Kushdo që nuk dëshiron t'ia adresojë shqetësime në fjalë strukturës më të afërt të EITI, mund ta bëjë këtë pranë Bordit EITI, përmes Komitetit të tij të Qeverisjes dhe kryetarit të tij.

I udhëhequr nga besimi se burimet natyrore të një vendi u përkasin qytetarëve të tij, EITI ka krijuar një **standard global** për të promovuar menaxhim të hapur dhe të përgjegjshëm të burimeve të naftës, gazit dhe mineraleve.

Standardi EITI kërkon bërjen publike të të dhënave përgjatë gjithë zinxhirit të industrisë nxjerrëse; nga mënyra se si jepen të drejtat e nxjerrjes, te mënyra se si menaxhohen dhe alokohen të ardhurat nga qeveria.

Në këtë mënyrë, EITI kërkon të nxisë bashkëpunimi midis palëve, duke promovuar një sektor më të shëndetshëm dhe më të përgjegjshëm, i cili mund të luajë një rol pozitiv në zhvillim.

Iniciativa e Transparencës së Industrisë Nxjerrëse

eiti.org